



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE**

**RAPORTI VJETOR**

**PËR VEPRIMTARINË E INSTITUCIONIT NË VITIN**

**2025**

[asd.gov.al](http://asd.gov.al)




## Tryeza e lëndës

Seksioni 1 – Rreth këtij raporti.....	4
1.1. Mesazhi i Kryetarit të Këshillit Drejtues.....	5
1.2. Përmbledhje ekzekutive.....	8
Seksioni 2 – Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. ....	10
2.1. Vlerësimi i veprimtarisë së Agjencisë dhe Rekomandimet e Rezolutës. ....	10
2.2. Veprimet e ndërmarra nga Agjencia për adresimin e rekomandimeve të Kuvendit. ....	12
Seksioni 3 – Skema e sigurimit të depozitave në Shqipëri .....	27
3.1. Depozitat në banka dhe shkk.....	27
3.2. Sigurimi i depozitave në banka. ....	28
3.2.1. Depozitat e sigurueshme në sistemin bankar.....	29
3.2.1.1. Depozitat e sigurueshme të individëve. ....	31
3.2.1.2. Depozitat e sigurueshme të tregtarëve e shoqërive tregtare.....	35
3.2.2. Depozitat e siguruara në sistemin bankar. ....	37
3.2.2.1. Depozitat e siguruara të individëve.....	38
3.2.2.2. Depozitat e siguruara të tregtarëve e shoqërive tregtare.....	39
3.3. Sigurimi i depozitave në shkk. ....	40
3.3.1. Depozitat e sigurueshme në shkk. ....	41
3.3.2. Depozitat e siguruara në shkk.....	43
Seksioni 4 – Administrimi i fondeve dhe burimeve financiare të Agjencisë.....	45
4.1. Fondi i sigurimit të depozitave në banka. ....	45



4.1.1. Ecuria e fondit të sigurimit të depozitave në banka.....	45
4.1.2. Treguesit kryesorë financiarë të fondit të sigurimit të depozitave në banka.....	45
4.1.3. Raporti i mbulimit të depozitave të siguruara në banka.....	48
4.2. Fondi i sigurimit të depozitave në shkk.....	49
4.2.1. Ecuria e fondit të sigurimit të depozitave në shkk.....	49
4.2.2. Treguesit kryesorë financiarë të fondit të sigurimit të depozitave në shkk.....	49
4.2.3. Raporti i mbulimit të depozitave të siguruara në shkk.....	51
4.3. Administrimi i mjeteve financiare.....	52
Seksioni 5 – Mirëqeverisja e organizatës.....	55
5.1. Këshilli Drejtues.....	55
5.2. Struktura organizative e Agjencisë.....	57
Seksioni 6 - Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025.....	58
Seksioni 7 – Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.....	65
7.1. Administrimi i Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.....	65
7.2. Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025.....	67




## **Seksioni 1 – Rreth këtij raporti.**

Raporti Vjetor 2025 ofron një panoramë të veprimtarisë financiare dhe administrative të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për periudhën 1 janar 2025 deri në 31 dhjetor 2025. Ky Raport është hartuar duke u bazuar në Ligjin nr. 53/2014, datë 22 maj 2014, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar me Ligjin nr. 39/2016 dhe Ligjin nr. 132/2016, Manualin e Monitorimit Vjetor dhe Periodik miratuar me Vendimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr. 134/2018, datë 20.12.2018, Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë “Për Vlerësimin e Veprimtarisë së Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për Vitin 2024”, si dhe në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e Agjencisë.

Pasqyrat financiare pasqyrojnë pozicionin financiar të Agjencisë më 31 dhjetor 2025 si dhe performancën e saj financiare e flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë. Këto pasqyra janë përgatitur në përputhje me Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF-të”). Bazuar në Ligjin nr. 53/2014, datë 22 maj 2014, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, pasqyrat financiare vjetore të Agjencisë auditohen dhe certifikohen nga auditues të jashtëm të specializuar.

Raporti vjetor dhe pasqyrat financiare janë miratuar nga Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave. Këshilli Drejtues ka ushtruar tagrat që i jep ligji për t’u siguruar që raporti vjetor dhe pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, performancën dhe administrimin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave gjatë vitit në raportim.

Jeni të lutur të jepni komentet tuaja për Raportin Vjetor 2025 në adresën [info@asd.gov.al](mailto:info@asd.gov.al). Ky Raport Vjetor, si dhe raportet vjetore të mëparshme, mund të konsultohen në faqen tonë zyrtare të internetit [www.asd.gov.al](http://www.asd.gov.al).




## 1.1. Mesazhi i Kryetarit të Këshillit Drejtues.

Të nderuar lexues,

Viti 2025 mund të konsiderohet një vit me ecuri të kënaqshme për veprimtarinë e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, në drejtim të përmbushjes së mandatit të saj ligjor për të administruar skemën e sigurimit të depozitave në Republikën e Shqipërisë. Si rezultat i stabilitetit të sistemit financiar në vend, gjatë vitit në raportim nuk pati ngjarje sigurimi që do të kërkonin ndërhyrjen e Agjencisë për të kompensuar depozituesit e siguruar në banka apo shoqëri kursim krediti. Një situatë e tillë qetësie është padyshim një zhvillim pozitiv. Megjithatë, ajo u vlerësua nga Agjencia si një mundësi e rëndësishme për t'i kushtuar vëmendje angazhimit institucional në lidhje me përfarimin e plotë me standardet e BE-së për sigurimin e depozitave. Në këtë drejtim, është punuar për zhvillimin e kapaciteteve operationale sa i takon rritjes së nivelit të gatishmërisë për ngjarje të mundshme sigurimi në të ardhmen si dhe adresimit të aspekteve ligjore dhe rregullative në funksion të linjësimit të plotë me acquis të BE-së, duke garantuar, në të njëjtën kohë, që Agjencia të jetë gjithmonë në gjendje të përmbushë me sukses mandatin e saj ligjor.


Për këtë arsye, gjatë vitit 2025 Agjencia përqendroi veprimtarinë e saj në forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve operationale përmes testimit të proceseve të përcaktuara, përmirësimit dhe përditësimit të tyre me praktikën më të mira dhe intensifikimit të bashkëpunimit me anëtarët e skemës së sigurimit të depozitave si dhe autoritet rregullatorë. Gjatë vitit u realizuan ushtrime periodike simulimi me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve të skemës së sigurimit të depozitave. Në këto simulime morën pjesë të gjitha palët përkatëse, përfshirë stafin e Agjencisë, si edhe përfaqësues të bankave dhe të shoqërive të kursim-kreditit. Për më tepër, me synimin për të testuar kapacitetet teknike dhe organizative të bankave të përzgjedhura si banka agjente, u zhvillua një ushtrim i posaçëm gjithëpërfshirës me njërin prej tyre. Rezultatet e këtij ushtrimi simulimi konfirmuan se Agjencia është e mirpërgatitur për të përballuar në mënyrë efektive skenarët e mundshëm të krizës.



Falë kontributeve të rregullta të bankave pjesëmarrëse në skemë, si dhe investimit prudent të fondeve në dispozicion, Fondi i Sigurimit të Depozitave në banka u rrit në 77.507 miliardë lekë në 31 dhjetor 2025, duke shënuar një rritje vjetore prej 10.5%. Ky nivel përfaqëson një tregues domethënës të qëndrueshmërisë së skemës, duke mbuluar me sigurim 7.83% të depozitave të siguruara në këto institucione financiare. Sa i takon Fondit të Sigurimit të Depozitave në shoqëritë e kursim kreditit ai shënoi një rritje prej 13.2% krahasuar me vitin 2024. Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, i krijuar në vitin 2016 dhe i administruar nga Agjencia, vijoi rritjen graduale të kapacitetit të tij. Pas kontributeve të vitit 2025, që arritën në 1.041 miliardë lekë, dhe të ardhurave nga administrimi i këtij fondi, totali i të tij në fund të vitit arriti në 7,024 miliardë lekë.

Gjatë vitit 2025, një ndër prioritetet kryesore të Agjencisë ishte procesi i harmonizimit të legjislacionit kombëtar për sigurimin e depozitave me Direktivën 2014/49/të Bashkimit Evropian. Në fund të vitit 2025, Agjencia finalizoi projektligjin e ri për sigurimin e depozitave, i cili iu dërgua për konsultim departamenteve përkatëse në Bankën e Shqipërisë. Ky proces është zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me Bankën e Shqipërisë dhe me ekspertizën e rëndësishme të konsulentëve të Bankës Botërore, të cilët asistuan në hartimin e projektligjit si dhe në kryerjen e analizave të ndikimit në lidhje me ndryshimin e elementëve thelbësore të skemës së sigurimit të depozitave, çka bën të mundur që projektligji të jetë sa më i përputhshëm me direktivat evropiane dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Në periudhën që pason, duke vlerësuar rëndësinë e plotësimit të të gjitha hallkave në funksion të realizimit të aspiratës kombëtare për aderimin në Bashkimin Evropian, Agjencia mbetet plotësisht e angazhuar në përmbylljen e procesit të harmonizimit të kuadrit ligjor me Direktivën 2014/49/BE. Në vijim, të përfundimit të procesit të konsultimit me Bankën e Shqipërisë, hapi i radhës do të jetë zhvillimi i një procesi të gjerë konsultimi publik me të gjithë anëtarët e skemës së sigurimit të depozitave. Pas përfundimit të këtij procesi, drafti përfundimtar do t'i paraqitet Këshillit të Ministrave



për miratim dhe, më pas, Kuvendit të Shqipërisë, në përputhje me afatet e përcaktuara në Programin Kombëtar për Integrimin Evropian.


Viti 2025 ishte një vit me sfida të rëndësishme, që nuk do të ishte e mundur të përballoheshin pa profesionalizmin dhe përkushtimin e ekipit të Agjencisë. Me këtë rast, dua t'u shpreh mirënjohjen time të sinqertë të gjithë punonjësve për kontributin e tyre të palodhur përgjatë vitit. Dëshiroj gjithashtu të falënderoj partnerët tanë institucionalë, Bankën e Shqipërisë, Ministrinë e Financave, komunitetin bankar dhe institucionet financiare ndërkombëtare, për bashkëpunimin e qëndrueshëm dhe të frytshëm, i cili jam i bindur se do të vijojë me të njëjtin ritëm edhe në të ardhmen.

Në përmbyllje, duke ju ftuar që përmes këtij raporti të informoheni për aktivitetin e Agjencisë, shpreh besimin se do të vijojmë punën për forcimin e kapaciteteve operacionale, rritjen e nivelit të gatishmërisë, si dhe intensifikimin e aktiviteteve të informimit dhe edukimit financiar për grupet tona të synuara. Të gjitha këto përpjekje synojnë të kontribuojnë në ruajtjen e stabilitetit dhe forcimin e mëtejshëm të besimit në sistemin bankar dhe financiar të Republikës së Shqipërisë.

Ju faleminderit.

Donald Duraj

Kryetar i Këshillit Drejtues




## 1.2. Përmbledhje ekzekutive

Agjencia e Sigurimit të Depozitave gjatë vitit 2025, ka siguruar depozitat e vendosura nga depozituesit në 11 banka dhe 9 shoqëri kursim krediti (shkk).

Për fundin e vitit 2025, totali i depozitave në sistemin bankar ishte 1,836 mld lekë me një rritje vjetore të tyre prej 9.1 %. Detyrimi i Agjencisë për kompensim në fund të këtij viti ishte 989 mld lekë, për 2,078,156 depozitues bankash. Në fund të vitit 2025, vlera e depozitave të sigurueshme që përfitojnë nga skema e sigurimit të depozitave arriti 1,742 mld lekë, duke përfaqësuar 94.9% të totalit të depozitave. Krahasuar me një vit më parë këto depozita u rritën me 9.5%, ndërsa rritja në vlerë absolute është 152 mld lekë. Depozitat e sigurueshme në lekë, për fundin e vitit 2025 zënë peshën më të madhe të totalit të depozitave të sigurueshme prej 47.7% të këtij totali, ndjekur nga depozitat në euro të shprehura në kundërvlerën në lek, me peshë 47.1%, dhe nga depozitat në USD me kundërvlerën e tyre në lekë me 3.7%. Depozitat e sigurueshme të individëve në sistemin bankar për fundin e vitit 2025 arritën në 1,387.4 mld lekë, duke përfaqësuar 79.6% të totalit të depozitave të sigurueshme. Në fund të vitit 2025 depozitat e siguruar në sistemin bankar ishin 53.9% e totalit të depozitave në sistemin bankar dhe 56.8% e depozitave të sigurueshme. 92.6% e depozituesve në banka kompensohen plotësisht.

Totali i depozitave në shkk për fundin e vitit 2025 ishte 12.3 mld lekë, nga 11.5 mld lekë që ishte në fund të dhjetorit 2024. Depozitat e sigurueshme janë 12.1 mld lekë dhe zënë 98,5% të totalit të depozitave, kundrejt 11.3 mld lekë që ishin një vit më parë. Këto depozita i korrespondojnë 46,978 depozituesve të shkk-ve në fund të vitit 2025. Depozitat e sigurueshme, gjatë vitit 2025 janë rritur me 7.4%. Në këtë rritje ndikimin më të madh e ka dhënë rritja e depozitave në lekë. Depozitat në lekë zënë peshën më të madhe të totalit të depozitave të sigurueshme të shkk-ve, 76.6%. Rritja vjetore e tyre është 6.7%. Në fund të vitit 2025, depozitat e siguruar në shkk janë 8.5 mld lekë, sa 68.8% të totalit të depozitave, ose 69.9% të depozitave të sigurueshme. 90.4% e depozituesve në shkk kompensohen plotësisht.




Fondet e sigurimit të depozitave në banka dhe në shoqëritë e kursim-kreditit kanë pasur një rritje të qëndrueshme gjatë vitit 2025. Të ardhurat kryesore që kontribuojnë në rritjen e këtyre fondeve janë të ardhurat nga primi i sigurimit dhe të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare.

Në 31 dhjetor 2025, vlera kontabël e fondit të sigurimit të depozitave në banka, është 77.5 mld lekë. Në krahasim me një vit më parë ky fond është rritur me rreth 7.3 miliard lekë ose 10.5%. Të ardhurat nga primet e sigurimit për vitin 2025 ishin 4.68 miliard lekë ose 6.4% më të larta se në vitin 2024. Kjo rritje reflekton edhe rritjen e depozitave të siguruara në sistemin bankar në vite. Të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare të fondit të sigurimit të depozitave në banka për vitin 2025, ishin 2.91 miliard lekë, ose 3% më shumë se në vitin 2024. Rritja e të ardhurave për vitin 2025 lidhet me zgjerimin e mjeteve financiare nën administrim dhe normat e interesit të titujve me afat maturimi të largët. Në fund të vitit 2025, raporti i mbulimit, i llogaritur si përqindje e fondit të sigurimit të depozitave në banka në krahasim me depozitat e siguruara, ishte 7.83%.

Në fund të vitit 2025, vlera kontabël e fondit të sigurimit të depozitave në shkk, është rreth 290.7 mln lekë duke shënuar një rritje prej 13.2 % krahasuar me një vit më parë. Të ardhurat nga primet e sigurimit për vitin 2025 ishin 24.64 milion lekë të cilat krahasuar me vitin 2024 janë rritur me 4.93 %. Të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare të fondit të sigurimit të depozitave në shkk përgjatë gjithë vitit 2025 ishin në shumën 9.68 milion lekë, të cilat krahasuar me vitin 2024 janë ulur me rreth 11%. Në fund të vitit 2025, raporti i mbulimit, i llogaritur si përqindje e fondit të sigurimit të depozitave në shkk në krahasim me depozitat e siguruara, ishte 3.43%.

Gjatë vitit 2025, Agjencia ka ushtruar përgjegjësinë ligjore për administrimin e FNJ, në përputhje me aktet e miratuara nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në Bankën e Shqipërisë. Kontributi vjetor i paguar nga bankat për vitin 2025 është 1.041 miliard lekë. Në 31 dhjetor 2025, vlera kontabël e aktiveve neto në dispozicion të autoritetit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme është 7,024 miliard lekë.



## Seksioni 2 – Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

### 2.1. Vlerësimi i veprimtarisë së Agjencisë dhe Rekomandimet e Rezolutës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

MIRATOHET

KRYETARI

Niko PELESHI

#### REZOLUTË

#### PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE PËR VITIN 2024

##### **Kuvendi i Shqipërisë,**

Duke njohur e vlerësuar rolin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për sigurimin dhe kompensimin e depozitave të qytetarëve, të vendosura në bankat që operojnë në Republikën e Shqipërisë;

Duke vlerësuar kontributin e saj në drejtim të rritjes së qëndrueshmërisë së sistemit financiar e bankar;

Duke mbështetur e zhvilluar bashkëpunimin me këtë Agjenci, si dhe duke nxitur bashkëpunimin e saj me institucionet kombëtare e ndërkombëtare;


**Vlerëson veprimtarinë e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave gjatë vitit 2024 në drejtim të:**

Performancës së mirë institucionale, e cila evidentohet nëpërmjet arritjes së një rezultati financiar pozitiv në fund të vitit në vlerën 6.62 miliardë lekë, me një rritje prej rreth 16% në krahasim me vitin 2023.

Miratimit nga Këshilli Drejtues të Planit Strategjik institucional për periudhën 2024-2026, dokument kyç që përcakton drejtimet strategjike të Agjencisë për periudhën trevjeçare.

Përmirësimin të infrastrukturës së saj teknike dhe kapaciteteve njerëzore, duke investuar në përgatitjen e stafit për të garantuar një reagim të shpejtë dhe efikas në rast të një ngjarje kompensimi, si dhe është trajnuar njësisia përkatëse për të ofruar sigurinë e nevojshme ndaj sulmeve kibernetike.

Intensifikimin të ndërveprimit me bankat dhe shoqëritë e kursim kreditit për të forcuar mekanizmat e mbrojtjes së depozituesve nëpërmjet zhvillimit të takimeve të rregullta rajonale, si dhe nëpërmjet realizimit të ushtrimeve teknike të simulimit dhe verifikimeve. Për më tepër, bazuar në përcaktimet ligjore dhe rregullative, është bërë në muajin korrik përzgjedhja e katër bankave, që për periudhën 2024-2026 do të shërbejnë në rolin e bankave agjente në rast të një procesi të mundshëm kompensimi.



Mbështetjes së dhënë në kuadër të procesit të integritimit evropian, si pjesë e grupit negociator për kapitullin 9 “Shërbimet financiare”. Agjencia ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për adresimin e çështjeve që nevojiten për përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit. Janë miratuar ndërhyrjet e nevojshme në aktet rregullatore, kjo nëpërmjet asistencës teknike të dhënë nga FinSAC të Bankës Botërore, si dhe me asistencën e dhënë nga BERZH-i është bërë gati metodologjia e aplikimit të primeve në bazë rreziku për subjektet anëtare të skemës.

Mbajtjes në fokus të vazhdueshëm institucional ndërgjegjësimin e publikut për skemën e sigurimit të depozitave dhe rritjes së edukimit financiar me ndihmën e grupeve të interesit dhe palët e tjera të përfshira në proces.

Intensifikimit të marrëdhënieve dhe shkëmbimit të ndërsjellët dhe të vazhdueshëm të përvojave me shoqatat e sigurimit të depozitave dhe organizmave ndërkombëtare, duke marrë pjesë në aktivitete për trajnimin e stafit, si dhe në drejtim të adoptimit të teknologjisë më të fundit në infrastrukturën e kompensimit.

**Kuvendi rekomandon që Agjencia e Sigurimit të Depozitave për periudhën në vijim të përmirësojë punën në këto drejtime:**

1. Të përshpejtojë përpjekjet për forcimin e kapaciteteve të saj operacionale në drejtim të përafrimit të plotë me standardet dhe legjislacionin e BE-së në fushën e sigurimit të depozitave, veçanërisht nëpërmjet kryerjes së analizave për rritjen e nivelit të mbulimit për kompensimin e depozitave dhe përditësimin të kornizës së brendshme rregullatore dhe operative, investimit në teknologji të avancuar për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave nga bankat anëtare, si dhe zhvillimin e një modeli efikas për menaxhimin e rreziqeve.

2. Të intensifikojë trajnimin e stafit teknik dhe përgatitjen për skenarë të mundshëm të falimentimeve bankare, në mënyrë që të garantohet një ndërhyrje e shpejtë dhe efektive në rastet e mbrojtjes së depozituesve.


3. Të zhvillojë dhe zbatojë një strategji gjithëpërfshirëse komunikimi dhe ndërgjegjësimi për publikun, që fokusohet në rritjen e njohurive të qytetarëve mbi funksionimin e skemës së sigurimit të depozitave, përmes mjeteve të aksesueshme dhe transparente, si: fushata informuese, platforma digjitale, mediat sociale dhe bashkëpunimi me sistemin arsimor.

4. Të përmirësojë raportimin institucional dhe të ndërtojë kanale efektive për komunikim të rregullt me aktorët financiarë, mediat dhe organizatat e shoqërisë civile.

5. Të ndërmarrë hapa konkretë për rritjen e mëtejshme të profesionalizimit të stafit, duke hartuar dhe zbatuar një strategji të zhvillimit të burimeve njerëzore, e cila përfshin kualifikimin dhe certifikimin e punonjësve në standarde ndërkombëtare, si dhe mekanizma të qartë vlerësimi të performancës.

6. Të angazhohet në rritjen e kapaciteteve të menaxhimit financiar, auditimit të brendshëm dhe digjitalizimit të proceseve të brendshme për të përmirësuar efikasitetin dhe transparencën institucionale.

Miratuar në datën 16.10.2025



## 2.2. Veprimet e ndërmarra nga Agjencia për adresimin e rekomandimeve të Kuvendit.

**Rekomandimi 1.** Të përshpejtojë përpjekjet për forcimin e kapaciteteve të saj operacionale në drejtim të përafrimit të plotë me standardet dhe legjislacionin e BE-së në fushën e sigurimit të depozitave, veçanërisht nëpërmjet kryerjes së analizave për rritjen e nivelit të mbulimit për kompensimin e depozitave dhe përditësimit të kornizës së brendshme rregullatore dhe operative, investimit në teknologji të avancuar për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave nga bankat anëtare, si dhe zhvillimin e një modeli efikas për menaxhimin e rreziqeve.

### **Masat e marra nga Agjencia.**


#### 1. Rishikimi i kuadrit ligjor të skemës së sigurimit të depozitave për përafrimin e plotë me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Në përputhje me rekomandimin e Kuvendit dhe në kuadër të detyrimeve që rrjedhin nga procesi i negociatave për Kapitullin 9 “Shërbimet financiare” me Komisionin Evropian, gjatë vitit 2025 Agjencia finalizoi hartimin e projektligjit të ri “Për sigurimin e depozitave”. Ky projektligj synon përafrimin e plotë me Direktivën 2014/49/BE “Për skemat e garantimit të depozitave”, duke e bërë skemën shqiptare të sigurimit të depozitave plotësisht të harmonizuar me me acquis të Bashkimit Evropian.

Hartimi i projektligjit përbën një nga iniciativat strategjike të Planit Strategjik të Agjencisë për periudhën 2024–2026, të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 2, datë 30.01.2024, dhe është një element kyç për përmbushjen e angazhimeve të vendit në procesin e integritit evropian. Për hartimin e këtij projektligji, Agjencia ka bashkëpunuar me asistencën teknike të zyrës FINSAC të Bankës Botërore.

Projektligji i ri sjell një sërë risish të rëndësishme, si:

- zgjerimi i fushës së zbatimit të skemës dhe përfshirja e kategorive të reja të depozituesve,
- llogaritja e primit të sigurimit mbi bazë rreziku,




- përcaktimi i nivelit të synuar të fondit të sigurimit të depozitave,
- rritja e nivelit të mbulimit dhe përfshirja e depozitave me balancë të përkohshme,
- përmirësimi i afateve dhe procedurave të kompensimit,
- bashkëpunimi ndërkufitar për sigurimin e depozitave.

Në këtë kuadër, Agjencia përfundoi analizat e ndikimit të ndryshimeve të propozuara, përfshirë efektet e rritjes së nivelit të mbulimit, aplikimin e primit të bazuar në rrezik dhe llogaritjen e nivelit të synuar të fondit të sigurimit të depozitave.

Përsa i përket rritjes së nivelit të mbulimit, projektligji parashikon një përafrim gradual dhe të strukturuar drejt nivelit të harmonizuar të mbulimit prej 100,000 euro të kërkuar nga Direktiva 2014/49/BE. Për të arritur këtë qëllim dispozitat përkatëse të projektligjit parashikojnë që rritja e nivelit të mbulimit të bëhet gradualisht për bankat anëtare të skemës, përkatësisht duke rritur nivelin e mbulimit nga kufiri aktual 2.500.000 lekë në 6.000.000 lekë. Në momentin e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, synohet që niveli i mbulimit të arrijë kundravlerën në lekë të shumës prej 100.000 euro, aq sa është edhe limiti në Bashkimin Evropian. Këto ndryshime përfaqësojnë rritjen më të madhe historike të nivelit të mbulimit për depozitat në banka në Shqipëri. Në këto kushte, rritja e nivelit të mbulimit në mënyrë graduale, nëpërmjet vlerës prej 6 milion lekë për bankat, nis një rrugë të strukturuar konvergjence drejt nivelit të harmonizuar të mbulimit sipas Direktivës 2014/49/BE. Ky parashikim synon të balancojë mbrojtjen e depozituesve me disiplinën e tregut, duke garantuar zbatimin e një mekanizmi financiarisht të qëndrueshëm. Në tërësi, rritja graduale e nivelit të mbulimit përbën një zhvillim të matur dhe strategjik të skemës së sigurimit të depozitave për të mbështetur objektivat më të gjera financiare, ekonomike dhe strategjike të Shqipërisë.

Paketa e plotë e projektligjit, e shoqëruar me analizat përkatëse, iu paraqit Bankës së Shqipërisë në dhjetor 2025 për shqyrtim dhe dakordësim. Ndryshimet e propozuara jo vetëm që mbrojnë më mirë depozituesit dhe rrisin eficiencën e menaxhimit të skemës,



por gjithashtu forcojnë stabilitetin e sistemit bankar dhe financiar. Në thelb, ky projektligj krijon një skemë sigurimi depozitash tërësisht të integrueshme në sistemin evropian, duke rritur besimin e publikut dhe duke kontribuar drejtpërdrejt në përmbushjen e kërkesave të Kapitullit 9 të negociatave me Bashkimin Evropian.


2. Investime në drejtim të rritjes së aftësisë së Agjencisë për të procesuar kontributin nga anëtarët e skemës.

Në vijim të rekomandimit të Kuvendit dhe në përputhje me ndryshimet ligjore që parashikojnë ndër ndërhyrjet më të rëndësishme për llogaritjen e primit vjetor me bazë rreziku për bankat anëtare të skemës së sigurimit të depozitave, Agjencia ka intensifikuar punën për modernizimin e procesit të mbledhjes dhe analizimit të të dhënave nga këto institucione financiare.

Me qëllim ndërtimin e një qasjeje sa më profesionale, të standardizuar dhe efikase, gjatë vitit 2025–2026 Agjencia është konsultuar me skemat homologe të sigurimit të depozitave në rajon dhe më gjerë, duke studiuar platformat dhe modelet e përdorura prej tyre për llogaritjen e kontributeve të bazuara në rrezik. Këto praktika kanë ndihmuar në identifikimin të zgjidhjeve më të mira dhe në krijimin e një panorame të qartë mbi kërkesat teknike dhe funksionale që duhet të plotësojë sistemi i ri.

Si rezultat i këtij procesi, Agjencia ka përfitur ekspertizë të vlefshme dhe ka hartuar një plan të detajuar të zhvillimit për ngritjen e një moduli të specializuar software, i cili do të mundësojë mbledhjen dhe analizimin automatik të të dhënave, si dhe për llogaritjen e koeficientit të primit të bazuar në rrezik për anëtarët e skemës. Ky modul synon të eliminojë pasaktësitë që mund të vijnë nga procedurat manuale dhe të garantojë një metodologji të harmonizuar me Direktivën e BE-së për Skemat e Sigurimit të Depozitave.

Në vijim, Agjencia do të hartojë Termat e Referencës për zhvillimin dhe implementimin e këtij sistemi të ri, duke hedhur bazat për modernizimin e mëtejshëm të procesit të



administrimit të kontributeve dhe rritjen e transparencës, profesionalizmit dhe efikasitetit në marrëdhëniet me bankat anëtare të skemës së sigurimit të depozitave.


### 3. Plani i vijueshmërisë së veprimtarisë.

Me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të menaxhimit të rreziqeve, Agjencia është angazhuar në një projekt bashkëpunimi me Zyrën e Asistencës Teknike të Departamentit të Thesarit të SHBA për rishikimin dhe modernizimin e planit të vijueshmërisë së veprimtarisë. Ky bashkëpunim synon hartimin e një dokumenti strategjik të përditësuar, i cili garanton funksionimin e pandërprerë të Agjencisë edhe në rast të situatave emergjente ose ndërprerjeve të papritura të veprimtarisë së saj.

Gjatë vitit 2025 është kryer një vlerësim gjithëpërfshirës i ndikimit të ndërprerjeve për secilin nga proceset e identifikuara si kritike për veprimtarinë e Agjencisë. Është realizuar kuantifikimi dhe standardizimi i masës së ndikimit në situata të tilla si mungesa e stafit, pamundësia për të përdorur ambientet fizike apo ndërprerjet e funksionimit të pajisjeve teknologjike. Ky proces ka shërbyer për të përcaktuar prioritetet ndërmjet funksioneve kritike dhe për të vlerësuar masat e nevojshme në drejtim të uljes së rrezikut. Si rezultat, gjatë këtij viti janë identifikuar dhe dokumentuar rrugët alternative për 10 funksionet kritike të Agjencisë.

Funksioni me ndikimin më të madh në veprimtarinë e Agjencisë është procesi i kompensimit, i cili është trajtuar veçmas për shkak të rëndësisë së tij strategjike. Për këtë proces është kryer një analizë e detajuar e të gjithë hapave dhe fazave gjatë të cilave kalon një kompensim. Janë identifikuar dhe vlerësuar momentet kritike dhe janë propozuar rrugëzgjdhje alternative, të cilat mbështeten kryesisht në qendrën alternative funksionale për sistemet IT (Disaster Recovery Site).

Ky projekt pritet të kontribuojë në zhvillimin e një modeli më efikas për menaxhimin e rreziqeve në Agjenci, duke mundësuar një qasje të parashikueshme dhe proaktive ndaj rreziqeve të mundshme operacionale. Përditësimi i planit të vijueshmërisë së veprimtarisë dhe forcimi i kapaciteteve për menaxhimin gjatë ndërprerjes së



veprimtarisë së Agjencisë, do të shërbejnë si bazë për ndërtimin e një strukture më të qëndrueshme institucionale.


**Rekomandimi 2.** Të intensifikojë trajnimin e stafit teknik dhe përgatitjen për skenarë të mundshëm të falimentimeve bankare, në mënyrë që të garantohet një ndërhyrje e shpejtë dhe efektive në rastet e mbrojtjes së depozituesve.

**Masat e marra nga Agjencia.**

1. Ushtrime simulimi teknike me anëtarët e skemës dhe simulime të dedikuara me bankat agjente.

Simulimet teknike të kryera me anëtarët e skemës së sigurimit të depozitave si dhe ato me bankat agjente konsiderohen jo vetëm një mjet efikas për të testuar saktësinë e gatishmërinë e sistemeve të raportimit dhe përpunimit të të dhënave dhe funksionimin operacional të tyre në përmbushjen e detyrimeve në rast të një ngjarjeje sigurimi, por në të njëjtën kohë, ato funksionojnë si një proces praktik trajnimi, duke i ekspozuar stafet e bankave/shkk-ve dhe të Agjencisë ndaj skenarëve realë të kompensimit dhe duke rritur aftësitë e tyre profesionale në menaxhimin e situatave kritike. Në këtë drejtim, gjatë vitit 2025, Agjencia ka kryer simulime teknike me të gjithë anëtarët e skemës, si dhe verifikime sipas planit të miratuar, me synim rritjen e mëtejshme të kapaciteteve teknike dhe gatishmërisë operationale për mbrojtjen efektive të depozituesve. Për këtë qëllim, duke vijuar edhe në vitin 2026, do të intensifikojmë përgatitjet teknike për skenarë të mundshëm të falimentimeve bankare, duke kryer simulime teknike me subjektet anëtare të skemës së sigurimit të depozitave, bankat dhe shoqëritë e kursim-kreditit. Këto simulime, të cilat përbëjnë një pjesë thelbësore të verifikimeve në vend, do të shërbejnë gjithashtu për trajnimin dhe përgatitjen e stafit teknik, duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve profesionale dhe gatishmërinë operationale në situata reale.

Gjithashtu, në kuadër të planit të simulimeve të dedikuara me bankat agjente, janë zhvilluar takime me përfaqësuesit e Bankës OTP, një prej katër bankave agjente të



përzgjedhura, e cila për herë të parë merr pjesë në këtë proces. Qëllimi i takimeve ka qenë kryerja e simulimit të një ngjarjeje sigurimi, i cili u zhvillua në dhjetor 2025. Në këtë ushtrim simulimi, u simulua procesi i kryerjes së pagesave për kompensim duke përdorur modulet e reja të implementuara në SIRK, të cilat automatizojnë të gjithë ciklin e kompensimit në rast ngjarjeje sigurimi. Simulimi i këtyre proceseve përbën një mundësi për trajnimin e stafit teknik dhe rritjen e kapaciteteve të tyre në adresimin e sfidave me të cilat mund të përballet Agjencia.


## 2. Ushtrim simulimi i Kontratës për Riblerjen e titujve me Bankën e Shqipërisë.

Në kuadër të forcimit të kapaciteteve profesionale të stafit teknik dhe rritjes së gatishmërisë institucionale për përballimin e skenarëve të mundshëm të falimentimeve bankare, Agjencia planifikoi dhe realizoi një ushtrim simulimi mbi zbatimin e Kontratës për Riblerjen e titujve me Bankën e Shqipërisë.

Kjo kontratë, e nënshkruar ndërmjet Agjencisë dhe Bankës së Shqipërisë në vitin 2022, përbën një instrument të rëndësishëm të menaxhimit të likuiditetit, duke i mundësuar Agjencisë transformimin e mjeteve financiare të investuara, nën administrimin e saj, në mjete likuide nëpërmjet operacioneve të riblerjes së titujve (REPO) me Bankën e Shqipërisë. Aktivizimi i kësaj kontrate krijon mundësinë e sigurimit të likuiditetit në kohë të shpejtë dhe në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, në rast të materializimit të nevojave për kompensimin e depozituesve.

Gjatë periudhës në raportim, Agjencia zhvilloi ushtrimin e simulimit në bashkëpunim të ngushtë me Bankën e Shqipërisë. Nëpërmjet këtij simulimi u arrit:

- përgatitja praktike e stafit teknik për kryerjen e analizave financiare mbi përdorimin optimal të mjeteve financiare në dispozicion;
- testimi i procedurave të brendshme për aktivizimin e kontratës së riblerjes;
- verifikimi i koordinimit institucional dhe i rrjedhës së komunikimit ndërmjet Agjencisë dhe Bankës së Shqipërisë;



- identifikimi i mundshëm i elementeve që kërkojnë përmirësim në aspektin operacional dhe dokumentar.

Ky ushtrim kontribuoi në rritjen e nivelit të gatishmërisë operationale të Agjencisë dhe në forcimin e mekanizmave të saj për sigurimin e likuiditetit në situata emergjente.


**Rekomandimi 3.** Të zhvillojë dhe zbatojë një strategji gjithëpërfshirëse komunikimi dhe ndërgjegjësimi për publikun, që fokusohet në rritjen e njohurive të qytetarëve mbi funksionimin e skemës së sigurimit të depozitave, përmes mjeteve të aksesueshme dhe transparente, si: fushata informuese, platforma digjitale, mediat sociale dhe bashkëpunimi me sistemin arsimor.

### **Masat e marra nga Agjencia.**

#### 1. Rishikimi i Strategjisë së Ndërgjegjëimit të Publikut.

Në kuadër të rekomandimeve të Kuvendit, Agjencia ka hartuar një strategji të re të ndërgjegjëimit të publikut, e cila mbështetet në kërkesat ligjore, standardet evropiane dhe analizën e përvojës së strategjisë aktuale. Përmes këtij dokumenti, është ngritur një qasje e strukturuar dhe gjithëpërfshirëse që synon rritjen e njohurive të qytetarëve mbi funksionimin e skemës së sigurimit të depozitave, qartësimin e përfitimeve dhe kufizimeve të saj dhe forcimin e besimit në sistemin financiar. Strategjia përcakton objektiva të qartë dhe parime udhëzuese si transparencja, komunikimi i rregullt dhe orientimi drejt qytetarit, duke plotësuar drejtpërdrejt kërkesën e rekomandimit për një strategji të aksesueshme, të balancuar dhe të qartë për publikun.

Në përmbushje të rekomandimit, strategjia integron një gamë të gjerë mjetesh komunikimi të kombinuara: kanale digjitale të Agjencisë (faqja zyrtare dhe rrjetet sociale), materiale edukative vizuale, fletëpalosje, broshura, trajnime dhe seminare për publikun dhe subjektet anëtare të skemës, si dhe bashkëpunimin me sistemin arsimor. Përdorimi paralel i mjeteve tradicionale dhe bashkëkohore siguron depërtim të gjerë në të gjitha grupet e synuara, përfshirë depozituesit, bankat dhe shkk-të, publikun e gjerë, nxënësit dhe studentët, përdoruesit aktivë të platformave online dhe grupet me akses të




kufizuar në informacion. Kjo qasje garanton që informacioni të jetë i aksesueshëm, i verifikuar dhe i përshtatur për profile të ndryshme të qytetarëve, duke reflektuar drejtpërdrejt orientimin e rekomandimit për komunikim të qartë dhe transparent.

Strategjia vendos gjithashtu theks të veçantë te komunikimi i koordinuar me institucionet e rrjetit të sigurisë financiare dhe me subjektet anëtare të skemës, duke e bërë këtë bashkëpunim një nga shtyllat themelore të saj. Në rast ngjarjesh sigurimi, dokumenti parashikon një qasje të ndërtuar mbi informim të shpejtë, të unifikuar dhe të strukturuar, duke siguruar që depozituesit të marrin informacion të saktë dhe të kuptueshëm për hapat e kompensimit. Me këtë strukturë, strategjia shndërrohet në një instrument të qëndrueshëm të komunikimit publik, që jo vetëm përmbush rekomandimin për të zhvilluar një strategji gjithëpërfshirëse ndërgjegjësimi, por edhe kontribuon në forcimin e besimit të publikut në sistemin bankar dhe financiar në vend.


## 2. Veprimtari në funksion të komunikimit dhe ndërgjegjësimit të publikut mbi funksionimin e skemës së sigurimit të depozitave.

Krahas hartimit të strategjisë së re, Agjencia gjatë vitit 2025 ka zbatuar dhe një plan të detajuar masash të cilat, përfshijnë si vijon:

- Bashkëpunimin me Bankën e Shqipërisë. Gjatë vitit të kaluar ky bashkëpunim u intensifikua më tej, përmes pjesëmarrjes së vazhdueshme të Agjencisë në veprimtaritë me qëllim edukimin financiar të organizuara nga Banka e Shqipërisë. Në këtë kuadër, Agjencia mori pjesë në aktivitetet e organizuara gjatë Javës Globale të Parasë, të mbajtura gjatë muajit mars 2025, duke ofruar prezantime dhe materiale informuese me fokus rritjen e edukimit financiar dhe ndërgjegjësimin e të rinjve mbi rolin e skemës së sigurimit të depozitave. Paralelisht, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, u analizuan dhe vlerësuan mundësitë për integrimin e materialeve të ASD-së në kurrikulat dhe programet edukative të sistemit arsimor dhe për publikun e gjerë.



- Bashkëpunimi me Shoqatën Shqiptare të Bankave u zgjerua më tej gjatë vitit 2025, përmes dakordësimit për pjesëmarrje të Agjencisë në takime dhe aktivitete të organizuara nga Shoqata. Gjithashtu, u siguroa integrimi i videove dhe materialeve informuese rrethe skemës së sigurimit të depozitave në faqen zyrtare të Shoqatës, duke rritur kështu dukshmërinë dhe aksesueshmërinë e informacionit për publikun depozitues.
- Bashkëpunimi me bankat anëtare të skemës. Ndërveprimi i Agjencisë me bankat u konsolidua ndjeshëm gjatë këtij vitit 2025. Në kuadër të këtij bashkëpunimi të konsoliduar dhe shkëmbimit të informacioneve mbi mënyrat dhe mjetet e komunikimit me depozituesit, Agjencia kaloi në fazën e zbatimit duke përdorur kanalet më efikase të identifikuara për përçimin e mesazheve ndërgjegjësuere dhe informuese mbi veprimtarinë e ASD-së. Kjo qasje e re komunikuese tashmë po aplikohet në praktikë, duke rritur ndikimin dhe koherencën e komunikimit me publikun depozitues. Gjithashtu, në kuadër të ushtrimit të simulimit, të zhvilluar me një nga bankat agjente të përzgjedhura, fokus i veçantë iu kushtua testimit të mekanizmave të komunikimit në rastet e ndodhjes së një ngjarje sigurimi, me synim forcimin e kapaciteteve operationale dhe rritjen e gatishmërisë institucionale. Në kuadër të këtij ushtrimi simulimi, me qëllim garantimin e një reagimi të koordinuar, transparent dhe efikas, u bashkëpunua me strukturat përkatëse të bankës agjente në të gjitha fazat e simulimit.
- Bashkëpunimi me shoqëritë e kursim-kreditit. Gjatë vitit 2025, Agjencia i dha një rëndësi të shtuar përmbushjes së detyrimit të informimit të depozituesve nga shoqëritë e kursim-kreditit anëtare të skemës së sigurimit të depozitave, nëpërmjet procesit të verifikimit në këto subjekte anëtare dhe dhënies së rekomandimeve për përmirësim të mëtejshëm në zbatimin e këtij detyrimi nga ana e tyre.



**Rekomandimi.4.** Të përmirësojë raportimin institucional dhe të ndërtojë kanale efektive për komunikim të rregullt me aktorët financiarë, mediat dhe organizatat e shoqërisë civile.


**Masat e marra nga Agjencia.**

Agjencia e Sigurimit të Depozitave, në zbatim të këtij rekomandimi dhe në kuadër të përmbushjes së detyrimeve të saj ligjore, ka vijuar të forcojë raportimin institucional dhe transparencën ndaj Kuvendit të Shqipërisë. Raportimi është kryer në përputhje me dispozitat e Manualit të Monitorimit Vjetor dhe Periodik, miratuar me Vendimin nr. 134/2018, duke iu përgjigjur në mënyrë të plotë të gjitha kërkesave për informacion nga komisionet dhe strukturat parlamentare.

Paralelisht, Agjencia ka intensifikuar bashkëpunimin me aktorët kryesorë rregullatorë të tregut bankar dhe financiar, veçanërisht me Bankën e Shqipërisë dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, me synim ndërtimin e kanaleve të qëndrueshme dhe efektive të komunikimit. Bashkëpunimi me Bankën e Shqipërisë është përqendruar në harmonizimin e legjislacionit kombëtar për sigurimin e depozitave me Direktivën e BE-së për skemat e garancisë së depozitave, si dhe në koordinimin e iniciativave të përbashkëta ligjore në funksion të procesit të përjasjes me standardet evropiane.

Bashkëpunimi me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, institucion përgjegjës për drejtimin e Kapitullit 9 “Shërbimet Financiare” pjesë e procesit të anëtarësimit në BE, është zhvilluar në kuadër të zbatimit të Programit Kombëtar për Aderimin në Bashkimin Evropian (PKABE). Në këtë drejtim, janë ndërmarrë iniciativa të përbashkëta për finalizimin e procesit ligjvënës dhe janë ngritur grupe pune të dedikuara për identifikimin dhe adresimin e sfidave që lidhen me përafrimin e legjislacionit të të dy institucioneve me acquis të BE-së.

Sa i përket procesit të hartimit të ligjit të ri “Për sigurimin e depozitave”, Agjencia do të ndjekë një qasje të strukturuar dhe të shtrirë në faza, duke përfshirë konsultime të



vazhdueshme me Bankën e Shqipërisë, ndjekjen e hapave të nevojshëm për përgatitjen e paketës ligjore dhe zhvillimin e një cikli konsultimesh, me qëllim informimin për ndryshimet e pritshme në skemën e sigurimit të depozitave, përfshirë nivelet e mbulimit, përlllogaritjen e primit bazuar në rrezik dhe nivelin e synuar të fondit të sigurimit të depozitave.


Për të siguruar transparencë të plotë dhe informim të gjerë publik, Agjencia do të vijojë organizimin e takimeve konsultuese me përfaqësuesit e subjekteve anëtare të skemës dhe do të intensifikojë komunikimin me median përmes intervistave dhe publikimeve informuese mbi përmbajtjen dhe ndikimin e ndryshimeve të pritshme ligjore. Në këtë kuadër, Agjencia do të zgjerojë gjithashtu formatet e komunikimit duke përfshirë grupet e interesit në procesin e informimit dhe konsultimit. Këto veprime do të realizohen në kuadër të konsultimit publik dhe përmes platformave zyrtare të dedikuara për procesin e konsultimit me publikun. Nëpërmjet këtij angazhimi, synohet krijimi i një dialogu të strukturuar dhe të vazhdueshëm me aktorët relevantë, duke përmbushur objektivin për forcimin e kanaleve efektive të komunikimit institucional.

**Rekomandimi.5.** Të ndërmerë hapa konkretë për rritjen e mëtejshme të profesionalizmit të stafit, duke hartuar dhe zbatuar një strategji të zhvillimit të burimeve njerëzore, e cila përfshin kualifikimin dhe certifikimin e punonjësve në standarde ndërkombëtare, si dhe mekanizma të qartë vlerësimi të performancës.

#### **Masat e marra nga Agjencia.**

Në zbatim të rekomandimit të Kuvendit, Agjencia e Sigurimit të Depozitave miratoi Strategjinë e rishikuar të Zhvillimit dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, e cila shërben për konsolidimin e kapaciteteve profesionale dhe përmirësimin e performancës së personelit.


Strategjia synon një qasje të integruar të zhvillimit dhe rritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore përmes:



- a) rritjes së intensitetit dhe cilësisë së programeve të trajnimit të ofruara nga organizatat ndërkombëtare si EFDI dhe IADI;
- b) forcimit të kapaciteteve profesionale dhe harmonizimit me praktikat e BE-së nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave me skemat homologe, si dhe trajnimit të stafit mbi kërkesat e acquis, përfshirë Direktivën 2014/49/BE “Për skemat e garantimit të depozitave”;
- c) zhvillimit të aftësive analitike, menaxheriale dhe ndërpersonale të stafit, me fokus në përmbushjen e objektivave strategjike të Agjencisë.

Në funksion të përmbushjes së rekomandimit për forcimin e kapaciteteve teknike dhe rritjen e gatishmërisë ndaj skenarëve të mundshëm të falimentimeve bankare, si dhe në zbatim të strategjisë së rishikuar për zhvillimin e burimeve njerëzore, Agjencia ka intensifikuar pjesëmarrjen në programet e trajnimit dhe bashkëpunimit teknik me organizata ndërkombëtare dhe skema homologe. Stafi teknik ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh të specializuara dhe shkëmbimesh profesionale që mbulojnë zhvillimet më të fundit mbi skemat e kompensimit, përmirësimin e vazhdimësisë operacionale dhe optimizimin e proceseve të kompensimit të depozituesve. Këtyre programeve u janë shtuar trajnimet mbi depozitat me tepricë të përkohshme (temporary high balances) dhe seminarët online të organizuara nga FinSAC, të cilat kanë trajtuar aspektet ligjore dhe operacionale të menaxhimit të bankave në vështirësi, përfshirë shitjen e bankave, bankat urë dhe ndërhyrjet e jashtëzakonshme.


Paralelisht, në kuadër të strategjisë së rishikuar dhe rekomandimit të Kuvendit për rritjen e profesionalizmit të stafit, Agjencia ka marrë pjesë në trajnime ndërkombëtare me EFDI, IADI dhe partnerë të specializuar, duke mbuluar tematika thelbësore si përlllogaritja e primit me bazë rreziku, menaxhimi i fondeve të sigurimit dhe proceset e ekzekutimit të kompensimit të depozituesve. Këto aktivitete të kombinuara kanë kontribuar ndjeshëm në forcimin e kapaciteteve profesionale dhe operacionale të stafit,



duke rritur aftësinë institucionale për ndërhyrje të shpejtë, të koordinuar dhe efektive në situatat që lidhen me mbrojtjen e depozituesve.

Në përputhje me strategjinë e rishikuar dhe duke marrë në konsideratë nevojat e identifikuar nga personeli i Agjencisë, gjatë vitit raportues janë zhvilluar një sërë konsultimesh dhe shkëmbimesh teknike me skemat homologe të sigurimit të depozitave në vendet e BE-së, të cilat kanë adresuar çështje thelbësore teknike dhe legislative në funksion të procesit të përafrimit të legjislacionit kombëtar me Direktivën 2014/49/BE. Vlerë të shtuar në këtë proces kanë dhënë takimet dhe bashkëpunimi i ngushtë në nivel teknik ndërmjet stafit të Agjencisë dhe ekspertëve të FinSAC, në kuadër të hartimit dhe përgatitjes së analizave të ndikimit të ndryshimeve të propozuara në projektligjin e ri “Për sigurimin e depozitave”. Këto analiza janë fokusuar në vlerësimin e efekteve të rritjes së nivelit të mbulimit, aplikimit të primit të bazuar në rrezik dhe llogaritjes së nivelit të synuar të fondit të sigurimit të depozitave në banka. Përmes këtij bashkëpunimi, stafi i Agjencisë ka përfutur qasje të avancuara metodologjike, praktika krahasuese nga skemat evropiane dhe mbështetje analitike të specializuara, duke forcuar kapacitetin për të modeluar skenarë rreziku dhe për të vlerësuar saktë implikimet financiare dhe operationale të ndryshimeve të propozuara. Si rezultat, këto veprimtari të kombinuara kanë kontribuar në rritjen e ndjeshme të kapaciteteve profesionale të personelit dhe në thellimin e kuptimit mbi standardizimin, funksionimin dhe harmonizimin e skemave të garantimit të depozitave në përputhje me kërkesat e BE-së.

Agjencia ka vijuar gjithashtu trajnime të specializuara në fushën e sigurisë kibernetike, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike (AKSK), të fokusuara në identifikimin dhe menaxhimin e kërcënimeve kibernetike, forcimin e mekanizmave mbrojtës, si dhe rritjen e ndërgjegjësimin institucional për sigurinë e informacionit dhe vazhdimësinë e operationeve në rast incidentesh. Paralelisht, bashkëpunimi me Zyrën e Asistencës Teknike (OTA) të Departamentit të Thesarit të SHBA-së ka mbështetur zhvillimin e njohurive të stafit mbi praktikat bashkëkohore dhe kornizat ndërkombëtare të sigurisë së informacionit, duke ofruar qasje praktike për



forcimin e kontrolleve teknike dhe organizative. Ky bashkëpunim ka kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit dhe të aftësisë së Agjencisë për të adresuar sfidat në rritje që lidhen me sigurinë e të dhënave dhe informacionit.

Agjencia zbaton një sistem periodik vlerësimi të performancës të miratuar nga Këshilli Drejtues i Agjencisë, i cili zhvillohet në mënyrë të strukturuar dhe të standardizuar, me qëllim garantimin e objektivitetit, transparencës dhe përmirësimit të vazhdueshëm të performancës individuale dhe institucionale. Punonjësit vlerësohen dy herë në vit, nëpërmjet një sistemi të bazuar në tregues të qartë dhe të matshëm, të lidhur drejtpërdrejt me objektivat vjetore, përgjegjësitë funksionale dhe rezultatet e pritshme të punës. Ky proces mundëson identifikimin e arritjeve, evidentimin e nevojave për zhvillim profesional, si dhe përmirësim të vazhdueshëm në përputhje me prioritetet strategjike të Agjencisë.


**Rekomandimi.6.** Të angazhohet në rritjen e kapaciteteve të menaxhimit financiar, auditimit të brendshëm dhe digjitalizimit të proceseve të brendshme për të përmirësuar efikasitetin dhe transparencën institucionale.

### **Masat e marra nga Agjencia.**

#### **Përmirësimi i menaxhimit financiar përmes digjitalizimit të proceseve të brendshme.**

Në kuadër të rritjes së kapaciteteve të menaxhimit financiar dhe forcimit të transparencës institucionale, Agjencia gjatë vitit 2025 ka ndërmarrë hapa konkretë për digjitalizimin e proceseve të saj të brendshme. Në këtë drejtim, është hartuar dokumentacioni përkatës teknik në përputhje me kërkesat ligjore për implementimin e një sistemi të ri informatik të integruar për menaxhimin e proceseve të punës në Agjenci.

Ky sistem do të mundësojë automatizimin dhe integrimin e proceseve financiare dhe administrative, duke siguruar mbledhjen, përpunimin dhe raportimin në kohë reale të të gjitha të dhënave financiare të Agjencisë. Nëpërmjet këtij sistemi synohet përmirësimi i ndjeshëm i efikasitetit operacional, reduktimi i proceseve manuale, minimizimi i riskut



të gabimeve njerëzore, si dhe rritja e nivelit të kontrollit të brendshëm dhe auditueshmërisë.

Implementimi i sistemit ERP do të ofrojë një pamje të plotë, të unifikuar dhe të përditësuar të performancës financiare të institucionit, duke mbështetur proceset e planifikimit buxhetor, monitorimit të shpenzimeve, administrimit të kontratave, menaxhimit të aktiveve dhe raportimit financiar. Gjithashtu, sistemi do të kontribuojë në rritjen e transparencës dhe në përmirësimin e vendimmarrjes përmes gjenerimit të raporteve analitike dhe statistikore të sakta dhe në kohë.

Realizimi i projektit gjatë periudhës 2026 do të përfshijë ndërtimin dhe implementimin e disa moduleve të specializuara, testimin dhe trajnimin e personelit, si dhe integrimin me sistemet ekzistuese, duke garantuar funksionalitet të plotë dhe përdorim efikas nga të gjithë punonjësit e përfshirë. Ky projekt konsiderohet një investim strategjik për modernizimin e infrastrukturës digjitale të Agjencisë dhe për forcimin afatgjatë të kapaciteteve të saj menaxheriale dhe financiare.




## Seksioni 3 – Skema e sigurimit të depozitave në Shqipëri .

### 3.1. Depozitat në banka dhe shkk.


Agjencia e Sigurimit të Depozitave gjatë vitit 2025 ka siguruar depozitat e depozituesve në 11 banka të sistemit, si dhe në 9 shoqëri kursim-krediti. Në fund të vitit 2025 totali i depozitave në sistemin bankar ishte 1,836 mld lekë, ndërsa totali i depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit ishte 12.3 mld lekë.

*Totali i depozitave në banka dhe shkk, për vitin 2025*



Agjencia sipas të dhënave për fund vitin 2025 ka detyrimin për kompensimin e 989 mld lekë depozitave në banka, apo të 2,078,156 depozituesve; si dhe detyrimin për kompensimin e 8.5 mld lekë depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit, apo të 22,961 depozituesve. Në totalin e detyrimeve të Agjencisë, prej 997.5 mld lekë, ndaj depozituesve që kanë vendosur depozitat e tyre në banka dhe shkk, 99.1% e zë detyrimi i Agjencisë ndaj depozituesve që i kanë vendosur depozitat e tyre në banka, ndërsa 0.9% është detyrimi i Agjencisë ndaj depozituesve që i kanë të vendosura depozitat e tyre në shoqëritë e kursim-kreditit. Agjencia kompenson plotësisht 92.6% të depozituesve në banka dhe 90.4% të depozituesve në shkk.


*Depozituesi në çdo bankë sigurohet në masën 100%, por në çdo rast jo më shumë se 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë, ndërsa depozituesi në shoqëritë e kursim-kreditit sigurohet në masën 100%, por në çdo rast jo më shumë se 2 000 000 (dy milionë) lekë, pavarësisht numrit të depozitave apo llojit të monedhës të tyre.*




### 3.2. Sigurimi i depozitave në banka.

Gjatë vitit 2025, totali i depozitave të sistemit bankar ka pasur ecuri pozitive. Krahasuar me një vit më parë këto depozita u rritën me 9.1 %, që i korrespondon një rritjeje në vlerë absolute prej 152.9 mld lekë.

#### *Ecuria e depozitave të sistemit bankar për fund vitet 2002-2025*



Totali i depozitave, depozitat e sigurueshme dhe ato të siguruara kanë ndjekur një rritje të qëndrueshme gjatë gjithë periudhës 2002–2025. Depozitat e pasigurueshme paraqiten në nivele më të ulëta dhe me luhatje të vogla, ndërsa depozitat e siguruara kanë një tendencë rritëse të qëndrueshme, duke reflektuar zgjerimin e mbulimit të skemës së sigurimit të depozitave dhe rritjen e bazës së depozituesve të siguruar, veçanërisht në vijim të ndryshimeve ligjore të miratuara nga Kuvendi në vitin 2017, të cilat përfshinë në subjektet e siguruara tregtarët dhe shoqëritë tregtare.




### 3.2.1. Depozitat e sigurueshme<sup>1</sup> në sistemin bankar.


Në fund të vitit 2025, vlera e depozitave të sigurueshme që përfitojnë nga skema e sigurimit të depozitave arriti 1,742 mld lekë, duke përfaqësuar 94.9% të totalit të depozitave. Krahasuar me një vit më parë këto depozita u rritën me 9.5 %, ndërsa rritja në vlerë absolute është 151.8 mld lekë. Depozitat e sigurueshme përfshijnë depozitat me afat, llogaritë rrjedhëse, llogaritë e kursimit, llogaritë e kartave, llogaritë e përbashkëta dhe produkte të tjera të ngjashme.

Depozitat e sigurueshme në lekë, në fund të dhjetorit 2025, zënë peshën më të madhe të totalit të depozitave të sigurueshme prej 47.7%, ndjekur nga depozitat në euro të shprehura në kundërvlerën 47.1%, dhe nga depozitat në USD me kundërvlerën e tyre në lekë, me 3.7%.

*Struktura e shumës së depozitave të sigurueshme të sistemit sipas monedhave*




<sup>1</sup> Ligji nr. 53/2014, datë 22 maj 2014, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar përcakton se “depozitë e sigurueshme” është vlera e agreguar e të gjitha depozitave të një depozituesi, përfshirë interesin e përlllogaritur të tyre në ditën e vlerësimit ose të ndërhyrjes në një subjekt anëtar të skemës, përveç përjashtimeve të nenit 32 të këtij ligji.




**Ecuria e depozitave të sigurueshme** në lekë gjatë vitit 2025 ka qenë pozitive në dhjetë muaj të periudhës, por normat e ndryshimit mujor kanë qenë relativisht të vogla, kurse një rënie relativisht të lehtë ka patur në muajt shkurt dhe prill. Norma më e madhe e ndryshimit mujor pozitiv ishte në fund të muajit janar prej +3.5%. Në fund të kësaj periudhe (dhjetor 2025) këto depozita arritën vlerën prej 831.6 mld lekë.

**Depozitat e sigurueshme në valutë** në muajin dhjetor 2025 përbëjnë 52.3 % të totalit të depozitave të sigurueshme dhe kundërvlera e tyre në lekë ishte 910 mld lekë. Norma pozitive e ndryshimit mujor për depozitat në monedhë të huaj të konvertuara në lekë është evidentuar gjatë shtatë muajve të vitit, kurse një rënie relativisht të lehtë ka patur në muajt shkurt, mars, qershor e nëntor. Rritja më e madhe prej 3.3 %, u shënuar në fund të muajit gusht, e cila erdhi si rezultat i rritjes së depozitave në euro, ku rritja mujore e tyre në monedhë origjinale ishte 3%, kurse kundërvlera e tyre në lekë shënoi rritje 3.4%.


*Ecuria e depozitave të sigurueshme të sistemit sipas monedhave 2015 – 2025*



Në fund të dhjetorit 2025, depozitat e sigurueshme më të vogla ose të barabarta me nivelin maksimal të mbulimit ishin 603.1 mld lekë (35% të totalit të shumës së depozitave të sigurueshme), kurse depozitat mbi nivelin maksimal të mbulimit arritën 1,138.9 mld lekë (ose 65% të totalit të shumës së depozitave të sigurueshme).




*Struktura e depozitave të sigurueshme krahasuar me nivelin e mbulimit 2.5 mln lekë*



### 3.2.1.1. Depozitat e sigurueshme të individëve.


Këto depozita në sistemin bankar më 31 dhjetor 2025 arritën 1,387.4 mld lekë, dhe përbëjnë pjesën më të madhe të totalit të depozitave të sigurueshme, konkretisht 79.6 % të tyre (norma e ndryshimit vjetor ishte +8.8%). Peshën më të madhe të depozitave të sigurueshme të individëve e zënë depozitat në lekë me 49.3%, ndjekur nga depozitat në euro me 45.6%. Gjatë vitit 2025 ecuria e depozitave të individëve në lekë ka qenë pozitive gjatë gjithë periudhës. Normat e ndryshimit mujor kanë qenë relativisht të ulta, dhe rritja më e madhe u shënuar në muajin dhjetor me 1.9%. Ndikimin më të madh në rritjen vjetore prej 8.8% të depozitave të sigurueshme të individëve, e kanë dhënë depozitat në lekë, të cilat shënuan një rritje vjetore prej 10.2%. Në dhjetor 2025, depozitat në monedhë të huaj të shprehura në kundërvlerën në lekë kanë peshën 50.7%, dhe rritja vjetore e tyre ishte 7.4%. Në këtë periudhë depozitat në euro të shprehura në kundërvlerën në lekë arritën shumën prej 631.9 mld lekë, duke shënuar një rritje vjetore në vlerë prej 47 mld lekë (në përqindje +8.1%), kurse në monedhën origjinale u rritën me 9.6%. Këto depozita zënë peshën më të madhe të depozitave të individëve në monedhë të huaj. Gjatë vitit 2025 ecuria e depozitave të individëve në euro ka qenë




pozitive gjatë gjithë periudhës, kurse të shprehura në kundërvlerën në lekë ecuria ka qenë në të dyja kahet pozitive dhe negative, si rezultat i ecurisë së kursit të këmbimit të lekut kundrejt euros. Rritja më e madhe mujore u shënua në muajin gusht me 2.1%, kurse të shprehura në kundërvlerën në lekë u rritën me 2.5%.

Depozitat e individëve në USD në monedhën origjinale, krahasuar me fundin e vitit 2024, u rritën me 19 %, kurse të shprehura në kundërvlerën në lekë (peshë e tyre 3.5%) kanë shënuar rritje vjetore me 4.1 % .

*Struktura e shumës së depozitave të siguroshme të individëve të sistemit sipas monedhave*




Gjatë vitit 2025, ecuria e depozitave të siguroshme të individëve deri në nivelin e mbulimit ka qenë pothuajse pozitive. Në fundin e vitit 2025, depozitat me shuma deri në 2.5 mln lekë kanë një peshë prej 41% kundrejt totalit të depozitave të siguroshme të individëve dhe krahasuar me fundin e vitit 2024, shënuan një rritje vjetore prej 6%. Kurse depozitat me shuma mbi nivelin e mbulimit, krahasuar me fundin e vitit 2024 janë rritur në vlerë absolute me rreth 80 mld lekë (ose 10.8%), duke ndikuar në rritjen vjetore prej 8.8% të depozitave të siguroshme të individëve.



Numri i depozituesve individë që sigurohen nga skema e sigurimit të depozitave në sistemin bankar, në fund të vitit 2025 është 2,928,343<sup>2</sup>. Në këtë numër janë përfshirë edhe depozituesit me balancë 0 deri në 100 lek (minimumi ligjor për kompensim), të cilët në dhjetor 2025 janë 1,011,375.

Ndër depozituesit individë me depozita më të mëdha se 100 lekë, 92.8% prej tyre ose 1,779,414 depozitues, i kanë depozitat deri në nivelin e mbulimit dhe përfitojnë mbulim të plotë nga skema e sigurimit të depozitave. Shuma e depozitave që u korrespondon këtyre depozituesve arriti vlerën 567.8 mld lekë. Depozituesit individë me depozita më të mëdha se 2.5 mln lekë në fund të dhjetorit 2025 janë 137,554 dhe shuma e depozitave të tyre arriti vlerën 819.6 mld lekë.


*Ecuria e numrit të depozituesve individë të sistemit bankar të klasifikuar sipas nivelit të mbulimit 2015-2025*



<sup>2</sup> Numri total i depozituesve është përcaktuar duke mbledhur të dhënat e agreguara të raportuara nga çdo bankë, kështu që një person i cili ka depozita në disa banka është regjistruar disa herë.





*Ecuria e numrit të depozituesve individë të sistemit bankar klasifikuar sipas nivelit të mbulimit 2015-2025 (në %)*



Për periudhën 2015-2025, përqindja e depozitave të individëve me vlerë deri në 2.5 mln lekë, varion nga 41% deri në 44% të totalit të depozitave të sigurueshme.

*Ecuria e depozitave të individëve të klasifikuara sipas nivelit të mbulimit 2015-2025 në %*







### 3.2.1.2. Depozitat e sigurueshme të tregtarëve e shoqërive tregtare.

Për sistemin bankar, këto depozita në dhjetor 2025 arritën 354.6 mld lekë dhe gjatë vitit u rritën me 12.7%. Depozitat me shuma deri në 2.5 mln lekë u rritën me 10.4 %, dhe pesha e tyre kundrejt totalit depozitave të sigurueshme të tregtarëve e shoqërive tregtare ishte 10%, kurse depozitat me shuma mbi 2.5 mln lekë (me peshë 90%), u rritën me 12.9 %.

Sipas llojit të monedhës, depozitat në euro të shprehura në kundërvlerën në lekë zënë peshën më të madhe të depozitave të tregtarëve e shoqërive tregtare prej 53.3%, dhe shënuan një rritje vjetore me 11.4%, kurse në monedhën origjinale u rritën me 13%. Gjatë vitit 2025 depozitat në euro në monedhën origjinale kanë patur ndryshim mujor pozitiv në muajt prill, maj, qershor, korrik, gusht e shtator dhe rritjen më të madhe e shënuan në muajin gusht me 6.3%. Depozitat në lekë zënë një peshë prej 41.7%, dhe shënuan një rritje vjetore me 17.8%, duke dhënë ndikimin më të madh në rritjen vjetore të depozitave të sigurueshme të tregtarëve e shoqërive tregtare. Depozitat në USD të shprehura në kundërvlerën në lekë zënë një peshë prej 4.4%, dhe shënuan një rënie vjetore me -10.6%


*Struktura e shumës së depozitave të sigurueshme të tregtarëve e shoqërive tregtare sipas monedhave*





Sipas kategorisë së produkteve, peshën më të madhe të depozitave të sigurueshme për depozituesit tregtarë e shoqëritë tregtare e zënë llogaritë rrjedhëse, me 86%.

*Struktura e shumës së depozitave të sigurueshme të tregtarëve & shoqërive tregtare sipas produkteve*




Në ndryshim nga situata e depozitave të sigurueshme të individëve, 90% e depozitave të tregtarëve e shoqërive tregtare janë me shuma mbi nivelin e mbulimit, dhe u korrespondojnë 16,905 depozituesve, të cilët përfaqësojnë 8.2% të depozituesve tregtarë e shoqërive tregtare. Pesha e kësaj kategorie depozituesish (me depozita më të mëdha se 2.5 mln lekë) si në numër ashtu edhe në shumë, në dhjetor 2025 është pothuajse e njëjtë me fundin e vitit 2024.




### 3.2.2. Depozitat e siguruar në sistemin bankar.

Në fund të vitit 2025 depozitat e siguruar në sistemin bankar arritën vlerën 989.3 mld lekë. Depozitat e siguruar përbëjnë 53.9% të totalit të depozitave në sistemin bankar dhe 56.8% të depozitave të sigurueshme.

*Ecuria e depozitave të sigurura në raport me totalin e depozitave dhe depozitat e sigurueshme - 2015-2025*




Rritja vjetore e depozitave të siguruar nga viti 2024 në vitin 2025 ishte 7.4%. Ndërkohë, për 10 vitet e fundit (2015-2025) rritja mesatare vjetore është në masën 5.14%.




### 3.2.2.1. Depozitat e siguruar të individëve.

Depozitat e siguruar të individëve për sistemin bankar në fund të dhjetorit 2025 ishin në vlerën 911.7 mld lekë dhe përbëjnë 66% të vlerës së depozitave të siguroshme të individëve.

*Ecuria e depozitave të siguruar të individëve në vlerë dhe ndryshimi vjetor në % 2015– 2025*




*Ecuria e depozitave të siguruar të individëve në vlerë gjatë vitit 2025*






*Ecuria e depozitave të siguruara të individëve kundrejt depozitave të sigurueshme 2015-2025*




**3.2.2.2. Depozitat e siguruara të tregtarëve e shoqërive tregtare**

Depozitat e siguruara të tregtarëve e shoqërive tregtare gjatë vitit 2025 u rritën me 9.9% dhe në fund të këtij viti arritën vlerën prej 77.5 mld lekë. Ecuria e këtyre depozitave gjatë vitit 2025, ka qenë në të dy kahet pozitive e negative, ku rritjen më të madhe e shënuan në muajin gusht me 3.72%, kurse rënie më madhe e shënuan në muajin shkurt përkatësisht me -1.6%.

*Ëcurie e depozitave të siguruara të tregtarëve & shoqërive tregtare në vlerë gjatë vitit 2025*






### 3.3. Sigurimi i depozitave në shkk.



Totali i depozitave të shkk-ve, në fund të vitit 2025 arriti në 12.3 mld lekë, nga 11.5 mld lekë që ishte në fund të dhjetorit 2024. Depozitat në shkk në fund të vitit 2025 kanë regjistruar një rritje vjetore në masën 7.4%, krahasuar me 5% që është regjistruar në vitin 2024. Ndryshimi mujor në përqindje i depozitave përgjatë vitit 2025 është luhatur në intervalin 0.03% deri në 1.3% krahasuar me intervalin -0.1% deri në 1% përgjatë vitit 2024. Ndryshe nga viti 2024, gjatë vitit 2025 ritmet e rritjes kanë qënë të lehta dhe pozitive duke reflektuar një stabilitet më të qëndrueshëm të depozitave në Shkk.

*Ecuria e depozitave të shkk-ve gjatë vitit 2025*



Në fillimin e aktivitetit të shkk-ve si anëtare të skemës së sigurimit të depozitave (janar 2017) kjo shumë ishte 4.1 mld lekë dhe krahasuar me këtë vlerë totali i depozitave në fund të vitit 2025 është 3 herë më i lartë. Norma mesatare e ndryshimit vjetor për gjatë aktivitetit të tyre 9 vjeçar si anëtare të skemës së sigurimit rezulton 12.7%.

*Ecuria e depozitave të shkk-ve gjatë periudhës janar 2017-dhjetor 2025*




### 3.3.1. Depozitat e sigurueshme në shkk.


Këto depozita në fund të dhjetorit 2025 janë 12.1 mld lekë dhe zënë 98,5% të totalit të depozitave, kundrejt 11.3 mld lekë që ishin më datë 31 dhjetor 2024. Këto depozita i korrespondojnë 46,978 depozituesve të shkk-ve, kundrejt 44,270 depozituesve që përfitonin nga skema e sigurimit të depozitave më datë 31 dhjetor 2024.

Depozitat e sigurueshme në fund të dhjetorit 2025, janë rritur me 7.4% krahasuar me një vit më parë ndërkohë që për vitin 2024 këto depozita janë rritur me 4.8% krahasuar me vitin 2023.

Në rritjen vjetore të depozitave të sigurueshme ndikim më të madh ka patur rritja e depozitave në lekë. Depozitat në lekë zënë peshën më të madhe të totalit të depozitave të sigurueshme të shkk-ve. Rritja vjetore e tyre është 6.7%.




*Struktura e shumës së depozitave të sigurueshme sipas monedhave në % - 31 dhjetor 2025*




Depozitat në monedhë të huaj zënë 23.4% të totalit të depozitave të sigurueshme, si rezultat i faktit që vetëm një pjesë e shkk-ve kanë depozita në valutë.

Në fund të dhjetorit 2025, depozitat e sigurueshme më të vogla ose të barabarta me nivelin maksimal të mbulimit ishin 4.1 mld lekë (e shprehur në përqindje 34% të totalit të shumës së depozitave të sigurueshme), kurse depozitat mbi nivelin maksimal të mbulimit arritën 8 mld lekë (ose 66% të totalit të shumës së depozitave të sigurueshme).

*Struktura e depozitave të sigurueshme krahasuar me nivelin e mbulimit 2 mln*






Shuma e vlerësuar për kompensim për depozitat që mbulohen pjesërisht është 4.4 mld lekë, dhe përbën 55% të totalit të depozitave të sigurueshme mbi 2 mln lekë, dhe 36% të totalit të depozitave të sigurueshme në shoqëritë e kursim kreditit.


Gjatë vitit 2025, përqindja e depozitave të sigurueshme me vlera deri në 2 mln lekë, kundrejt totalit të depozitave të sigurueshme, për periudhat tremujore është pothuajse konstante prej 34%.

### 3.3.2. Depozitat e siguruara në shkk.

Në fund të vitit 2025, depozitat e siguruara në shkk janë 8.5 mld lekë. Kjo shumë përbën 69% të totalit të depozitave, ose 70% të depozitave të sigurueshme.


#### *Ecuria e depozitave të siguruara gjatë vitit 2025*





Numri i depozituesve që i kanë depozitat 101-2 mln lekë në fund të dhjetorit 2025 është 20,762, dhe krahasuar me fundin e vitit 2024 ka shënuar një rritje prej 2.8%. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i depozituesve të rinj të shkk-ve gjatë vitit 2025. Këta depozitues përbëjnë 90% të totalit të depozituesve që përfitojnë nga skema e sigurimit të depozitave. Numri i depozituesve që i kanë depozitat në vlerën mbi 2 mln lekë në fund të dhjetorit 2025 është 2,199 dhe këta përbëjnë 10% të totalit të depozituesve që përfitojnë nga skema.

*Ecuria e numrit të depozituesve të siguruar gjatë vitit 2025*



■ Nr. i depozituesve të siguruar me depozita mbi 2 mln lekë ■ Nr. i depozituesve të siguruar me depozita 101-2 mln lekë




## Seksioni 4 – Administrimi i fondeve dhe burimeve financiare të Agjencisë.

### 4.1. Fondi i sigurimit të depozitave në banka.

#### 4.1.1. Ecuria e fondit të sigurimit të depozitave në banka.

Në 31 dhjetor 2025, vlera kontabël e fondit të sigurimit të depozitave në banka, i cili përbëhet nga fondi themeltar prej 400 milion lekë dhe fitimet e akumuluar ndë vite, është 77.507 miliard lekë. Në krahasim me një vit më parë ky fond është rritur me rreth 7.3 miliard lekë ose 10.5%. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet ecuria e fondit të sigurimit të depozitave për periudhën 2015 – 2025.


*Fondi i sigurimit të depozitave në banka (në mijë lekë)*



#### 4.1.2. Treguesit kryesorë financiarë të fondit të sigurimit të depozitave në banka.


Madhësia e fondit të sigurimit të depozitave në banka përcaktohet nga të ardhurat neto nga aktiviteti ndër vite. Të ardhurat kryesore që kontribuojnë në rritjen e fondit të sigurimit të depozitave në banka janë të ardhurat nga primi i sigurimit dhe të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare.

Në përputhje me Ligjin “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, duke filluar nga viti 2015, primi i sigurimit të depozitave përlllogaritet në baza tremujore. Për bankat primi




tremujor i sigurimit përlllogaritet si 0.125% e mesatares aritmetike të shumës së depozitave të siguruara, që janë regjistruar në bankë në ditën e fundit të çdo muaji të tremujorit të mëparshëm dhe për shkk-të primi tremujor i sigurimit përlllogaritet si 0.075% e mesatares aritmetike të shumës së depozitave të siguruara, që janë regjistruar në shkk në ditën e fundit të çdo muaji të tremujorit të mëparshëm. Primi tremujor i sigurimit për subjektet anëtare të skemës së sigurimit paguhet jo më vonë se data 15 e muajit të parë të tremujorit për të cilin paguhet.

*Primet e sigurimit në banka (në mijë lekë)*



Të ardhurat nga primet e sigurimit për vitin 2025 ishin 4.68 miliard lekë ose 6.4% më të larta se në vitin 2024. Të ardhurat nga primet e sigurimit përgjatë periudhës 2015 – 2025 kanë qenë në rritje, gjë që lidhet drejtpërsëdrejti me rritjen e depozitave të siguruara në sistemin bankar në këto vite.

Të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare të fondit të sigurimit të depozitave në banka për vitin 2025 ishin 2.91 miliard lekë ose 3% më shumë se në vitin 2024. Ky zë të ardhurash përgjatë periudhës 2015 – 2025 ka qenë në rritje, gjë që lidhet drejtpërsëdrejti me zgjerimin e mjeteve financiare nën administrim dhe normat e interesit të letrave me vlerë. Fondet e Agjencisë janë të investuara kryesisht në bono





thesari dhe obligacione të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Si rrjedhojë, portofoli i investimeve është i ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit, për shkak të luhatjeve në yield-et e këtyre titujve në tregun vendas të letrave me vlerë. Gjatë vitit 2025, normat e interesit kanë shfaqur një tendencë rënëse krahasuar me vitet paraardhëse, kryesisht për maturitet afatshkurtra dhe afatmesme, duke reflektuar zhvillimet në politikën monetare dhe kushtet e përgjithshme të tregut financiar.

Gjithsesi, të ardhurat e Agjencisë nga administrimi i mjeteve financiare për vitin 2025 kanë shënuar rritje, si rezultat i zgjerimit në vlerë nominale të portofolit, të ardhurave të gjeneruara prej investimeve me maturitete afatgjata të realizuara në vitet e mëparshme, të cilat janë kontraktuar në nivele interesi më të favorshme si dhe madhësisë nominale të fondit.

Paralelisht, Agjencia ka vijuar strategjinë e saj për diversifikimin e portofolit sipas maturiteteve të ndryshme, me qëllim optimizimin e raportit rrezik–kthim dhe menaxhimin më efikas të ekspozimit ndaj luhatjeve të normave të interesit. Ky diversifikim ka kontribuar pozitivisht në stabilitetin dhe rritjen e të ardhurave nga investimet gjatë periudhës raportuese.

*Të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare të fondit të sigurimit të depozitave në banka (në mijë lekë)*







#### 4.1.3. Raporti i mbulimit të depozitave të siguruara në banka.

Në fund të vitit 2025, depozitat e siguruara në sistemin bankar ishin 989.2 miliard lekë ose 7.4% më të larta se një vit më parë. Rritja e qëndrueshme e fondit të sigurimit të depozitave në banka dhe ecuria më e moderuar e depozitave të siguruara në sistemin bankar gjatë periudhës 2015 – 2025 kanë sjellë një rritje të vazhdueshme të raportit të mbulimit gjatë këtyre viteve. Në fund të vitit 2025, raporti i mbulimit, i llogaritur si përqindje e fondit të sigurimit të depozitave në banka në krahasim me depozitat e siguruara, ishte 7.83%. Në grafikun në vijim paraqitet një përmbledhje e ecurisë së depozitave të siguruara në sistemin bankar dhe raportit të mbulimit përgjatë viteve 2015 – 2025.

*Raporti i mbulimit dhe depozitat e siguruara në banka (në mijë lekë)*






## 4.2. Fondi i sigurimit të depozitave në shkk.

### 4.2.1. Ecuria e fondit të sigurimit të depozitave në shkk.


Në përputhje me Ligjin ‘Për sigurimin e depozitave’, i ndryshuar, në Janar të vitit 2015, u arkëtua nga Buxheti i Shtetit fondi themeltar për sigurimin e depozitave në shkk në vlerë 76 milion lekë. Ky fond, siguroi bazën fillestare financiare të fondit të sigurimit të depozitave në shkk. Duke nisur nga viti 2015 e në vazhdim, Agjencia ka administruar mjetet financiare të fondit të sigurimit të depozitave në shkk, të cilat hynë në skemë në Janar 2017. Në 31 dhjetor 2025, vlera kontabël e fondit të sigurimit të depozitave në shkk, i cili përbëhet nga fondi themeltar prej 76 milion lekë, dhe fitimet e akumuluar, është rreth 290.76 milion lekë duke shënuar një rritje prej 13.2% krahasuar me vitin 2024.

#### *Fondi i sigurimit të depozitave në shkk (në mijë lekë)*



### 4.2.2. Treguesit kryesorë financiarë të fondit të sigurimit të depozitave në shkk.


Të ardhurat kryesore që kontribuojnë në rritjen e fondit të sigurimit të depozitave në shkk janë të ardhurat nga primi i sigurimit dhe të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare.



Në përputhje me legjislacionin në fuqi, subjektet të cilat u pranuan për të hyrë në skemë nga Janari 2017, filluan të derdhin primet tremujore të sigurimit.

Të ardhurat nga primet e sigurimit për vitin 2025 ishin 24.64 milion lekë e cila krahasuar me vitin 2024 është rritur me 4.93 %.


*Primet e sigurimit në shkk (në mijë lekë)*



Të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare të fondit të sigurimit të depozitave në shkk përgjatë gjithë vitit 2025 ishin në shumën 9.68 milion lekë, të cilat krahasuar me vitin 2024 janë ulur me rreth 11%. Gjatë rinovimit të titujve ekzistues apo investimit të likuiditeteve të reja, fondi është përballur me norma interesi më të ulëta në ankandet e organizuara, çka ka ndikuar drejtpërdrejt në nivelin e të ardhurave nga interesi. Një faktor tjetër i rëndësishëm që ka ndikuar në këtë zhvillim është edhe madhësia e vogël e portofolit të investimeve të këtij fondi. Ky portofol duke patur një volum të kufizuar ka kapacitet më të ulët për të amortizuar efektet negative të rënies së normave të interesit, pasi mungon masa kritike që do të mundësonte shpërndarjen më efektive të riskut dhe optimizimin e kthimeve përmes diversifikimit apo zgjatjes së maturitetit. Për rrjedhojë, çdo reduktim i normave të tregut reflektohet më ndjeshëm në të ardhurat totale të gjeneruara.




*Të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare të fondit të sigurimit të depozitave në shkk (në mijë lekë)*




**4.2.3. Raporti i mbulimit të depozitave të siguruara në shkk.**

Në fund të vitit 2025, depozitat e siguruara për shkk-të ishin rreth 8.47 miliard lekë ose 5.18% më të larta se një vit më parë. Në fund të vitit 2025, raporti i mbulimit, i llogaritur si përqindje e fondit të sigurimit të depozitave në shkk në krahasim me depozitat e siguruara, ishte 3.43%. Në grafikun në vijim paraqitet një përmbledhje e ecurisë së depozitave të siguruara në shkk-të dhe raportit të mbulimit përgjatë viteve 2017 – 2025.

*Raporti i mbulimit dhe depozitat e siguruara në shkk (në mijë lekë)*







### 4.3. Administrimi i mjeteve financiare.

Më 31 Dhjetor 2025, mjetet financiare të Agjencisë për fondin Banka, janë në vlerë nominale 76.673 miliard lekë, nga të cilat 66.493 miliard lekë janë të investuara në letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare në monedhën lekë, në depozita një javore ose gjendje në llogari pranë Bankës së Shqipërisë dhe 10.180 miliard lekë në monedhën euro nga të cilat, 2.342 miliard lekë në letra me vlerë të qeverisë shqiptare në tregun ndërkombëtar dhe 7.838 miliard lekë në bondet e qeverive evropiane dhe gjendje në llogari pranë bankës kujdestare Raiffeisen Bank International. Në funksion të administrimit me efektivitet të mjeteve financiare dhe të garantimit në çdo kohë të nevojave për mjete likuide financiare, Agjencia në përputhje me politikën e investimit në fund të vitit 2025 kishte 12.91% të portofolit në instrumente shumë likuid, si letra me vlerë në maturitet të mbetur deri në 3 muaj, depozita dhe llogari rrjedhëse me Bankën e Shqipërisë dhe në Raiffaisen Bank International si edhe letra me vlerë me maturitet të mbetur deri në 90 ditë. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet një përmbledhje e mjeteve financiare të Agjencisë sipas transheve të investimit më 31 Dhjetor 2025.

*Mjetet financiare sipas transheve të investimit*




Agjencia mban pjesën me të madhe të mjeteve financiare në monedhën lekë dhe një pjesë të mjeteve të saj financiare në valutë në monedhën Euro. Në përputhje me Politikën e Investimeve, investimet në monedhë të huaj përbëjnë 13.30% të mjeteve




financiare nën administrim dhe në planin afatgjatë synohet afrimi i strukturës sipas monedhës për portofolin e Agjencisë me atë të depozitave të siguruara. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet një përmbledhje e mjeteve financiare të Agjencisë sipas valutës më 31 Dhjetor 2025.

*Mjetet financiare sipas valutave*




Në funksion të administrimit me efektivitet të mjeteve financiare dhe të garantimit në çdo kohë të nevojave për mjete likuide financiare, mjetet financiare kanë një shpërndarje të shkallëzuar sipas kohëzgjatjes deri në maturim.

Pas miratimit të Ligjit nr. 53/14 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, Agjencia ka zhvendosur rreth 53.26% të portofolit të saj të investimit në instrumente me maturitet të mbetur nga 3- 24 muaj dhe rreth 33.83% të portofolit të saj në instrumente me maturitet të mbetur mbi 24 muaj. Në grafikun që vijon paraqitet shpërndarja e mjeteve financiare sipas kohëzgjatjes deri në maturim më 31 Dhjetor 2025.





*Mjetet financiare sipas kohëzgjatjes deri në maturim*



Më 31 Dhjetor 2025, mjetet financiare të Agjencisë për fondin e Shoqërive të Kursim Kredit me vlerë nominale 290.101 milion lekë, janë të investuara të gjitha në letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare, në depozita një javore ose gjendje në llogari pranë Bankës së Shqipërisë.

Në funksion të administrimit me efektivitet të mjeteve financiare dhe të garantimit në çdo kohë të nevojave për mjete likuide financiare, Agjencia në përputhje me politikën e investimit në fund të vitit 2025 kishte 11.41% të portofolit në instrumente shumë likuid, si depozita dhe llogari rrjedhëse me Bankën e Shqipërisë. Dhe pjesën tjetër të portofolit të investuar në maturitet 12 muaj deri në 15 vite. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet një përmbledhje e mjeteve financiare të shkk sipas transheve më 31 Dhjetor 2025.





## **Seksioni 5 – Mirëqeverisja e organizatës.**

### **5.1. Këshilli Drejtues.**


Bazuar në Ligjin nr. 53/2014 datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar dhe Statutin e Agjencisë, Këshilli Drejtues është organi më i lartë vendimmarrës i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, përgjegjës për kryerjen edhe mirëfunksionimin e aktiviteteve dhe veprimtarisë së Agjencisë.

Roli i Këshillit Drejtues përqendrohet në përgjegjësitë e tij mbikëqyrëse, duke vepruar në mënyrë të pavarur dhe duke vlerësuar performancën e drejtimit të Agjencisë përkundrejt kërkesave ligjore, rekomandimeve të institucioneve kushtetuese (Kuvendi i Republikës së Shqipërisë) dhe mbikëqyrëse (Banka e Shqipërisë), në të cilat Agjencia raporton, si dhe objektivave të përcaktuara në aktet rregullative të Agjencisë.

Këshilli Drejtues përbëhet nga pesë anëtarë, të emëruar nga Autoriteti Mbikëqyrës. Dy anëtarë propozohen nga Autoriteti Mbikëqyrës, dy anëtarë propozohen nga Ministri i Financave të Republikës së Shqipërisë dhe një anëtar propozohet nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar. Anëtarët e Këshillit Drejtues janë jo ekzekutivë, me përjashtim të anëtarit që emërohet në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm.

Bazuar në detyrimin që në çdo kohë të veprojnë me ndershmëri në interesin më të mirë të Agjencisë, anëtarët e Këshillit Drejtues ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me kompetencat e përcaktuara në Ligjin nr. 53/2014 datë 22.05.2014 “Për Sigurimin e Depozitave”, i ndryshuar, Statutin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, Rregulloren “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave” dhe legjislacionin në fuqi për organet kolegjiale.

Procesi i vendimmarrjes i Këshillit Drejtues, përgjatë vitit 2025, është udhëhequr nga parimet e ligjshmërisë, profesionalizmit, pavarësisë dhe transparencës. Sipas programit të miratuar për vitin 2025, vendimmarrja e Këshillit Drejtues ka prodhuar 41 vendime në funksion të vendosjes dhe ruajtjes së standardeve të larta në mirëqeverisjen e



Agjencisë si dhe konsolidimin e kapaciteteve të saj për të përmbushur mandatin ligjor. Vendimmarrja e Këshillit u përqendrua kryesisht në miratimin e akteve nënligjore me qëllim miradministrimin e skemës së sigurimit të depozitave si dhe mbarëvajtjen e veprimtarisë operationale të Agjencisë.

Gjatë vitit 2025 Këshilli Drejtues i Agjencisë ka pasur përbërjen sipas tabelës më poshtë.

KËSHILLI DREJTUES	FUNKSIONI	INSTITUCIONI PROPOZUES
Donald Duraj	Kryetar	Banka e Shqipërisë
Genci Mamani <sup>3</sup>	Anëtar	Banka e Shqipërisë
Adela Xhemali <sup>4</sup>	Anëtar	Ministri i Financave
Erjona Bejleri <sup>5</sup>	Anëtar	
Endrit Yzeiraj <sup>6</sup>	Anëtar	
Vasilika Vjero <sup>7</sup> Andi Memeti <sup>8</sup>	Anëtar	Ministri i Financave
Shkëlzen Margjeka	Anëtar	Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA)

<sup>3</sup> Mandati përfundoi në datë 03.07.2025.


<sup>4</sup> Mandati përfundoi në datë 21.03.2025.

<sup>5</sup> Mandati përfundoi në datë. 01.10.2025.

<sup>6</sup> Emëruar me Urdhër të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr. prot. 4733, datë 24.10.2025.

<sup>7</sup> Mandati përfundoi në datë 06.08.2025.

<sup>8</sup> Emëruar me urdhër të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr. prot. 4173, datë 23.07.2025.





## 5.2. Struktura organizative e Agjencisë.

Struktura organizative e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave është miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 19, datë 29.08.2013 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe numrin e punonjësve në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të ndryshuar.

Bazuar në Statutin e Agjencisë të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018 dhe në zbatim të strukturës së saj organizative Agjencia organizohet në mënyrë hierarkike, drejtohet nga Këshilli Drejtues dhe administrohet nga Drejtori i Përgjithshëm.

Sipas kësaj strukture Agjencia është e përbërë nga 7 sektorë, dhe ka në total një staf prej 29 punonjësish.





## Seksioni 6 - Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025.

**Deloitte.**

Deloitte Audit Albania Shpk  
Rruga Muhedim Llagami, Njësia  
Administrative nr. 7, Kompleksi Delijorgji,  
Godina MD-Biznes, Kati 1, 2, 3, 4 dhe 5,  
Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 45 17 920  
Fax: +355 4 45 17 990  
[www.deloitte.com/al](http://www.deloitte.com/al)

### RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

#### Aksionarëve dhe Drejtimit të Agjencia e Sigurimit të Depozitave

##### Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Agjencia e Sigurimit të Depozitave ("Agjencia"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2025 dhe pasqyrën e te ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe informacionet mbi politikat materiale të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar e Agjencisë më 31 dhjetor 2025 si dhe performancën e saj financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet e Kontabilitetit SNRF.

##### Baza për Opinionin

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Ligjin e Auditimit dhe me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" të raportit tonë. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Agjencia në përputhje me Bordin e Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët' Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Kontabilistët Profesionalistë (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (kodi "BKSNE"), siç zbatohet për auditimin e pasqyrave financiare të njësive ekonomike me interes publik, si dhe me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare të njësive ekonomike me interes publik në Shqipëri. Ne kemi përmbushur gjithashtu përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BKSNE.


Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

##### Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor 2024 u audituan nga një auditues tjetër, i cili shprehu një opinion të pa modifikuar mbi këto pasqyra më 25 Mars 2025.

##### Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionet që jepen në Raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe Raportin e drejtimit të brendshëm, i përgatitur nga drejtimi në përputhje me Nenin 17 dhe 19 të Ligjit 25/2018, datë 19 janar 2019 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, por nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të audituesve mbi këto pasqyra. Raporti i ecurisë së veprimtarisë dhe Raporti i drejtimit të brendshëm parashikohen të na vihen në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesve.



### Informacione të tjera (Vazhdim)

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera, të identifikuar më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë pasaktësi materiale me pasqyrat financiare, apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale.

Pasi të lexojmë Raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe Raportin e drejtimit të brendshëm, nëse, në bazë të punës që kemi kryer, arrijmë në përfundimin se ka një anomali materiale të informacioneve të tjera, ne na kërkohet të raportojmë këtë fakt. Nuk kemi asgjë për të raportuar për këtë fakt.

### Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Agjencisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Agjencisë, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse sa më lart.


Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Agjencisë.

### Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie material, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.



### Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brendshme të Agjencisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Agjencisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidences së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Agjencisë për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.
- Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Agjencisë, ku përveçse çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ne gjithashtu u komunikojmë atyre që janë përgjegjës për qeverisjen një deklaratë që kemi respektuar kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë dhe komunikojmë me ta të gjitha marrëdhëniet dhe çështjet e tjera që mund të konsiderohen se ndikojnë në pavarësinë tonë, si dhe, kur është e zbatueshme, veprimet e ndërmarra për të eliminuar kërcënimet ose masat mbrojtëse të zbatuara.

*Deloitte Audit Albania sept*

Deloitte Audit Albania shpk

Rruga Muhedin Llagami, Njësia Administrative nr. 7, Kompleksi Delmorgji, Godina MD-Biznes, Kati 1,2, 3, 4 dhe 5, Tiranë, Shqipëri

Numri Unik i Identifikimit të Subjektit (NUIS): L41709002H



*Enida Cara*

Partner Angazhimi  
Auditues ligjor  
Enida Cara

Tiranë, Shqipëri  
09 Mars 2026



**Pasqyra e pozicionit financiar.**

	Shënime	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
<b>AKTIVET</b>			
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	8	2,601,171,975	2,096,063,998
Instrumente financiare të mbajtura për të mbledhur flukset kontraktuale	9	75,145,754,404	68,253,878,313
Aktive afatgjata materiale, neto	10	51,230,491	58,836,072
Aktive afatgjata jo materiale, neto	11	4,689,225	2,027,225
Aktive të tjera, neto	12	5,134,690	4,427,163
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>		<b>77,807,980,784</b>	<b>70,415,232,771</b>
<b>DEYRIMET</b>			
Detyrime të tjera	13	9,538,790	16,580,902
<b>TOTALI I DETYRIMEVE</b>		<b>9,538,790</b>	<b>16,580,902</b>
<b>FONDI I SIGURIMIT TË DEPOZITAVE</b>			
Fondi themeltar për sigurimin e depozitave në banka	14	400,000,000	400,000,000
Fondi themeltar për sigurimin e depozitave në Shoqëri Kursim Krediti (“shkk”)	14	76,000,000	76,000,000
Fondi i akumuluar për sigurimin e depozitave në banka		77,107,679,711	69,741,779,608
Fondi i akumuluar për sigurimin e depozitave në shkk		214,762,093	180,872,273
<b>TOTALI I FONDIT TË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE</b>		<b>77,798,441,805</b>	<b>70,398,651,881</b>
<b>TOTALI I DETYRIMEVE DHE FONDIT TË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE</b>		<b>77,807,980,785</b>	<b>70,415,232,771</b>



**Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse.**

	Shënime	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
<b>Të ardhura operative</b>			
Të ardhura nga primet e sigurimit	15	4,707,105,333	4,422,317,060
Të ardhura nga interesat	17	2,927,637,727	2,843,668,202
Të ardhura të tjera operative	18	3,243,723	3,151,927
<b>Totali i të ardhurave operative</b>		<b>7,637,986,783</b>	<b>7,269,137,189</b>
<b>Shpenzime financiare</b>			
Humbje nga përkthimi në monedhë të huaj		(126,959,075)	(512,960,331)
Shpenzime të tjera financiare	19	(7,333,786)	(6,566,126)
<b>Totali i shpenzimeve financiare</b>		<b>(134,292,861)</b>	<b>(519,526,457)</b>
<b>Shpenzime operative</b>			
Shpenzime personeli	20	(86,836,151)	(89,638,794)
Shpenzime administrative	21	(22,578,176)	(29,840,830)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	10, 11	(11,573,770)	(12,811,839)
<b>Totali i shpenzimeve operative</b>		<b>(120,988,097)</b>	<b>(129,624,317)</b>
Rimarrje/(Shpenzime) provigjioni të instrumenteve financiare të mbajtur për të mbledhur flukse kontraktuale, neto	8, 9	17,084,106	2,962,918
<b>TEJKALIMI I TË ARDHURAVE NDAJ SHPENZIMEVE PËR VITIN</b>		<b>7,399,789,931</b>	<b>6,622,949,333</b>
<b>Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse</b>		-	-
<b>TOTALI I TË ARDHURAVE GJITHËPËRSHIRËSE</b>		<b>7,399,789,931</b>	<b>6,622,949,333</b>



**Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare.**

Shënime	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
<b>Tejkalimi i të ardhurave ndaj shpenzimeve për vitin</b>	<b>7,399,789,931</b>	<b>6,622,913,334</b>
<b><i>Rregullime për:</i></b>		
Të ardhura nga interesat	17 (2,927,637,727)	(2,843,668,202)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	10, 11 11,573,770	8,819,992
Lëvizja në fondin e provigjonit për instrumentet financiare	9 (12,624,907)	(2,952,774)
<b><i>Ndryshimet në:</i></b>		
Aktive të tjera	(707,527)	1,395,253
Detyrime të tjera	(7,042,112)	2,693,107
Interesi i arkëtuar	2,874,252,777	2,712,747,607
<b>Fluksi i mjeteve monetare gjeneruar nga aktiviteti operativ</b>	<b>7,337,604,205</b>	<b>6,501,948,317</b>
<b>AKTIVITETI INVESTUES</b>		
Blerje e aktiveve afatgjata	11 (2,667,189)	(9,713,204)
Shtesat e instrumenteve financiare të mbajtura për të mbledhur flukse kontraktuale	(6,828,413,423)	(5,801,124,498)
<i>Blerë gjatë vitit</i>	(34,132,822,828)	(33,762,830,000)
<i>Maturuar gjatë vitit</i>	27,304,409,405	27,961,705,502
<b>Fluksi i mjeteve monetare përdorur në aktivitetin investues</b>	<b>(6,832,496,423)</b>	<b>(5,810,837,702)</b>
<b>Rritja / neto e mjeteve monetare gjatë vitit</b>	<b>505,107,782</b>	<b>691,110,614</b>
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre në fillim të vitit	8 2,096,063,998	1,404,953,188
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre në fund të vitit</b>	<b>2,601,171,975</b>	<b>2,096,063,998</b>



**Pasqyra e ndryshimeve në fondet e sigurimit të depozitave.**

	<b>Fondi themeltar për sigurimin e depozitave në banka</b>	<b>Fondi themeltar për sigurimin e depozitave në shkk</b>	<b>Fondi i akumuluar për sigurimin e depozitave në banka</b>	<b>Fondi i akumuluar për Sigurimin e Depozitave Në shkk</b>	<b>Totali</b>
<b>Më 1 janar 2024</b>	<b>400,000,000</b>	<b>76,000,000</b>	<b>63,152,868,055</b>	<b>146,834,492</b>	<b>63,775,702,547</b>
Tejkalimi i të ardhurave ndaj shpenzimeve për vitin	-	-	6,588,911,553	34,037,780	<b>6,622,949,333</b>
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>	-	-	<b>6,588,911,553</b>	<b>34,037,780</b>	<b>6,622,913,334</b>
<b>Më 31 dhjetor 2024</b>	<b>400,000,000</b>	<b>76,000,000</b>	<b>69,741,779,608</b>	<b>180,872,273</b>	<b>70,398,651,881</b>
Tejkalimi i të ardhurave ndaj shpenzimeve për vitin	-	-	7,365,900,104	33,889,820	<b>7,399,789,924</b>
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2025</b>	<b>400,000,000</b>	<b>76,000,000</b>	<b>77,107,679,711</b>	<b>214,762,093</b>	<b>77,798,441,805</b>




## **Seksioni 7 – Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.**


### **7.1. Administrimi i Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.**

Me ligjin nr.133/2016 datë 22.12.2016 “Për Rimëkëmbjen dhe Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në Banka në Republikën e Shqipërisë”, Agjencisë së Sigurimit të Depozitave i janë caktuar kompetencat për administrimin e këtij fondi. Administrimi i Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme është kryer në përputhje me Politikën e Administrimit të Mjeteve Financiare të FNJ, miratuar nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në Bankën e Shqipërisë. Fondi është bërë efektiv duke filluar nga data 1 Janar 2018. Banka e Shqipërisë është Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme që ushtron të drejtat e ndërhyrjes të përcaktuara në Ligj. Banka e Shqipërisë përllëgarit çdo vit kontributin vjetor që sektori bankar do të paguajë për arritjen e nivelit të synuar të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme. Kontributi vjetor i paguar nga Bankat për vitet 2018-2025 është në shumën 5.04 miliard lekë dhe për vitin 2025 është paguar 1.041 miliard lekë. Në 31 dhjetor 2025, vlera kontabël e aktiveve neto në dispozicion të autoritetit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme është 7,024 miliard lekë.

Mjetet financiare të Fondit janë investuar në përputhje me strategjinë vjetore të investimit për vitin 2025, miratuar nga Komiteti i Investimeve i Agjencisë. Këto mjete financiare me vlerë nominale 6.927 miliard lekë në 31 dhjetor 2025, janë të investuara të gjitha në letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare dhe depozita një javore e llogari rrjedhëse pranë Bankës së Shqipërisë. Në funksion të administrimit me efektivitet të mjeteve financiare të këtij fondi, Agjencia në përputhje me politikën e administrimit të mjeteve financiare në fund të vitit 2025 kishte 12.94% të portofolit në instrumente shumë likuid, si llogari rrjedhëse dhe depozita me Bankën e Shqipërisë dhe letra me vlerë me maturitet të mbetur deri në 90 ditë. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet një përmbledhje e mjeteve financiare të FNJ sipas transheve të investimit më 31 Dhjetor 2025.




*Mjetet financiare sipas transheve të investimit*



Mjetet financiare të FNJ janë në masën më të madhe në lekë. Në përputhje me Politiken e Administrimit të Mjeteve Financiare të FNJ, investimet në monedhë të huaj përbëjnë 5.69% të mjeteve financiare nën administrim. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet një përmbledhje e mjeteve financiare të FNJ sipas valutës më 31 Dhjetor 2025.

*Mjetet financiare sipas valutave*



Agjencia për llogari të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, administron dhe mban llogari të veçanta kontabël për mjetet financiare të këtij fondi. Agjencia përgatit dhe raporton pranë Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme portofolin e mjeteve financiare të Fondit si edhe pasqyrat financiare tremujore të tij. Pasqyrat Financiare vjetore të Fondit auditohen nga shoqëri auditimi të çertifikuara e të pavarura.



## 7.2. Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025.

**Deloitte.**

Deloitte Audit Albania Shpk  
Rruga Muhećin Llagami, Njësia  
Administrative nr. 7, Kompleksi Delijorgji,  
Godina MD-Biznes, Kati 1, 2, 3, 4 dhe 5,  
Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 45 17 920  
Fax: +355 4 45 17 990  
[www.deloitte.com/al](http://www.deloitte.com/al)

### RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

#### Aksionarëve dhe Drejtimit të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme

##### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ("Fondi"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2025 dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe informacionet mbi politikat materiale të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar e Fondit më 31 dhjetor 2025 si dhe performancën e tij financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet e Kontabilitetit SNRF.

##### Baza për Opinionin

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Ligjin e Auditimit dhe me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" të raportit tonë. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Fondi në përputhje me Bordin e Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët' Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Kontabilistët Profesionistë (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (kodi "BKSNE"), siç zbatohet për auditimin e pasqyrave financiare të njësive ekonomike me interes publik, si dhe me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare të njësive ekonomike me interes publik në Shqipëri. Ne kemi përmbushur gjithashtu përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BKSNE.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

##### Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor 2024 u audituan nga një auditues tjetër, i cili shprehu një opinion të pa modifikuar mbi këto pasqyra më 25 Mars 2025.

##### Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionet që jepen në Raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe Raportin e drejtimit të brendshëm, i përgatitur nga drejtimi në përputhje me Nenin 17 dhe 19 të Ligjit 25/2018, datë 19 janar 2019 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, por nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të audituesve mbi këto pasqyra. Raporti i ecurisë së veprimtarisë dhe Raporti i drejtimit të brendshëm parashikohen të na vihen në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesve.



### Informacione të tjera (Vazhdim)

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzionin që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera, të identifikuar më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë pasaktësi materiale me pasqyrat financiare, apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale.

Pasi të lexojmë Raportin e ecursionit dhe Raportin e drejtimit të brendshëm, nëse, në bazë të punës që kemi kryer, arrijmë në përfundimin se ka një anomali materiale të informacioneve të tjera, ne na kërkohet të raportojmë këtë fakt. Nuk kemi asgjë për të raportuar për këtë fakt.

### Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Fondit për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Fondit, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse sa më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondit.

### Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie material, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.



### Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brendshme të Fondit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Fondit për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidences së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Fondit për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.
- Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Fondit, ku përveçse çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ne gjithashtu u komunikojmë atyre që janë përgjegjës për qeverisjen një deklaratë që kemi respektuar kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë dhe komunikojmë me ta të gjitha marrëdhëniet dhe çështjet e tjera që mund të konsiderohen se ndikojnë në pavarësinë tonë, si dhe, kur është e zbatueshme, veprimet e ndërmarra për të eliminuar kërcënimet ose masat mbrojtëse të zbatuara.

*Deloitte Audit Albania's sept*

Deloitte Audit Albania shpk

Rruga Muhedin Llagami, Njësia Administrative nr. 7, Kompleksi Deljorgji, Godina MD-Biznes, Kati 1,2, 3, 4 dhe 5, Tiranë, Shqipëri

Numri Unik i Identifikimit të Subjektit (NUIS): L41709002H




*Enida Cara*  
Partner Angazhimi  
Auditues ligjor  
Enida Cara

Tiranë, Shqipëri  
09 Mars 2026




**Pasqyra e pozicionit financiar.**

	Shënime	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
<b>AKTIVET</b>			
<b>Aktivët afatshkurtra</b>			
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	8	746,505,959	686,282,289
Instrumente financiare të mbajtur për të mbledhur flukset kontraktuale	9	6,281,936,351	5,051,716,011
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>		<b>7,028,442,310</b>	<b>5,737,998,300</b>
<b>DETYRIMET</b>			
Detyrime të tjera	10	4,365,505	3,728,441
<b>TOTALI I DETYRIMEVE</b>		<b>4,365,505</b>	<b>3,728,441</b>
<b>AKTIVET NETO NË DISPOZICION TË AUTORITETIT TË NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME</b>			
Aktivët neto në dispozicion të ANJ		5,734,269,859	4,552,502,197
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		1,289,806,946	1,181,767,662
<b>TOTALI AKTIVEVE NETO NË DISPOZICION TË AUTORITETIT TË NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME</b>		<b>7,024,076,805</b>	<b>5,734,269,859</b>
<b>TOTALI I DETYRIMEVE DHE I AKTIVEVE NË DISPOZICION TË AUTORITETIT TË NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME</b>			
		<b>7,028,442,310</b>	<b>5,737,998,300</b>



**Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave gjithpërfshirëse.**

<b>TË ARDHURA</b>	<b>Shënime</b>	<b>31 dhjetor 2025</b>	<b>31 dhjetor 2024</b>
<b>Të ardhura operative</b>			
Të ardhura nga kontributi vjetor	<b>11</b>	1,041,020,620	982,134,585
Të ardhura nga interesat	<b>12</b>	259,147,248	219,572,067
<b>TOTALI I TË ARDHURAVE</b>		<b>1,300,167,868</b>	<b>1,201,706,652</b>
 <b>SHPENZIME FINANCIARE</b>			
Humbje nga përkthimi në monedhë të huaj		(7,082,392)	(15,834,224)
<b>TOTALI I SHPENZIMEVE FINANCIARE</b>		<b>(7,082,392)</b>	<b>(15,834,224)</b>
 <b>SHPENZIME OPERATIVE</b>			
Shpenzime operative nga aktiviteti	<b>13</b>	(4,365,955)	(3,728,442)
<b>TOTALI I SHPENZIMEVE OPERATIVE</b>		<b>(4,365,955)</b>	<b>(3,728,442)</b>
 Rimarrje / Shpenzime provigjioni të mjeteve monetare dhe ekuivalent të tyre	<b>8</b>	1,087,424	(520,705)
Rimarrje / Shpenzime provigjioni të instrumenteve financiare të mbajtur për të mbledhur flukse kontraktuale	<b>9</b>	-	744,710
<b>TEPRICA NETO PËR VITIN</b>		<b>1,289,806,945</b>	<b>1,182,367,992</b>
 <b>TEJKALIMI I TË ARDHURAVE NDAJ SHPENZIMEVE PËR VITIN</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
 <b>TOTALI I TË ARDHURAVE GJITHËPËRSHIRËSE</b>		<b>1,289,806,945</b>	<b>1,182,367,992</b>



## Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
<b>Shënime</b>		
Tejkalimi i të ardhurave ndaj shpenzimeve për vitin	1,289,806,946	1,181,767,662
<b>Rregullime për:</b>		
Të ardhura nga interesat	(259,147,248)	(219,572,067)
Levizja në fondin e provigjonit për instrumentet financiare		
<b>Ndryshimet në:</b>		
Detyrime të tjera	637,513	624,515
Interesi i arkëtuar		
<b>Fluksi i mjeteve monetare gjeneruar nga aktiviteti operativ</b>	<b>1,031,297,211</b>	<b>962,820,108</b>
<b>AKTIVITETI INVESTUES</b>		
Blerje e instrumenteve financiare të mbajtur për të mbledhur flukse kontraktuale	(1,200,000,000)	(943,416,400)
Blerë gjatë vitit	(2,650,000,000)	(2,200,000,000)
Maturuar gjatë vitit	1,450,000,000	1,256,583,600
Interesi i mbledhur	228,926,908	184,413,331
<b>Fluksi i mjeteve monetare përdorur në aktivitetin investues</b>	<b>(971,073,092)</b>	<b>(759,003,069)</b>
<b>Rritja / neto e mjeteve monetare gjatë vitit</b>	<b>60,224,119</b>	<b>203,817,039</b>
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre në fillim të viti	8	8
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre në fund të vitit</b>	<b>746,506,959</b>	<b>686,282,289</b>



**Pasqyra e ndryshimeve të aktiveve neto në dispozicion të autoritetit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.**

	<b>Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme</b>
<b>Aktivet neto në dispozicion të autoritetit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme më 1 janar 2024</b>	<b>4,552,502,197</b>
Teprica neto nga veprimtaria për periudhën Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin	1,181,767,662
<b>Aktivet neto në dispozicion të Autoritetit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme më 31 dhjetor 2024</b>	<b>5,734,269,859</b>
Teprica neto nga veprimtaria për periudhën Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin	1,289,806,946
<b>Aktivet neto në dispozicion të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme më 31 Dhjetor 2025</b>	<b>7,024,076,805</b>